



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2023, ora 13:00 *online*

Drejton mbledhjen:

Evis Kushi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me rektorët e universiteteve publike të rretheve për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.
2. Seancë dëgjimore me rektorët e universiteteve publike të Tiranës për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.
3. Seancë dëgjimore me Akademinë e Shkencave për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.
4. Diskutimi dhe miratimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

Marrin pjesë:

Evis Kushi, Lindita Buxheli, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Ilir Topi, Ilir Metaj, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Eslemvera Zake, Meri Markici, Ina Zhupa, Kastriot Piroli, Eralda Bano, Merita Baku, Orjela Nebijaj dhe Ismet Beqiraj (zëvendësues).

Mungojnë:

Flutura Aça, Petro Koçi, Andia Ulliri dhe Agron Gjekmarkaj.

Të ftuar:

Prof. dr. Skënder Topi – rektor i universitetit “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan,
Prof. dr. Rajmonda Kçira – rektore e komanduar e universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër,
Prof. dr. Saimir Xhelaj – administrator i universitetit “Ismail Qemali” në Vlorë,

Prof. dr. Kseanela Sotirofski – rektore e universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës,
Albana Tole – zëvendësministre e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit,
Mirela Bimo – drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e
Arsimit dhe Sporteve,
Gentian Opre – drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, në Drejtorinë e Analizës
dhe Programimit Buxhetor, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,
Vilma Çausholli – përgjegjëse sektori në Sektorin e Analizës së Buxhetit Qendror, në
Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

HAPET MBLEDHJA

Evis Kushi – Të nderuar kolegë, përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e radhës të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Si fillim verifikojmë kuorumin. Pjesëmarrës në këtë mbledhje janë deputetët: Eduard Ndreca, Eralda Bano, Ina Zhupa, Lindita Buxheli, Teuta Ramaj, Ilir Topi, Meri Markiçi, Dasantila Tahiraj, Blerina Gjylameti, Merita Bakiu, Enslemvera Zake dhe Kastriot Piroli. Kuorumin e kemi, kështu që fillojmë menjëherë mbledhjen *online*.

Ju lutem, kolegë deputetë, edhe një herë dakordësinë tuaj që ta zhvillojmë *online* këtë mbledhje, për arsytet që të gjithë i dimë, bazuar edhe në vendimin e Konferencës së Kryetarëve.

Jeni të gjithë dakord ta vijojmë mbledhjen në këtë format? Po, faleminderit!

Sot në rendin e ditës kemi dy mbledhje. Në mbledhjen e parë kemi seancë dëgjimore me rektorët e universiteteve publike të rretheve dhe të Tiranës, përkatësisht, në orën 13:00 dhe në orën 14:00. Ndërkohë që në mbledhjen e dytë, në orën 15:00, kemi seancë dëgjimore me Akademinë e Shkencave për të diskutuar në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024”, dhe më pas diskutimi dhe miratimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, seancën dëgjimore me rektorët e universiteteve publike të rretheve për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”. Të ftuar nga universiteti “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan kemi rektorin, prof. dr. Skënder Topin. Faleminderit, profesor! Nga universiteti “Luigj Gurakuqi” në Shkodër, prof. dr. Rajmonda Kçira, rektore e komanduar; nga universiteti “Ismail Qemali” në Vlorë, është administratori, prof. dr. Saimir Xhelaj; nga universiteti “Aleksandër Moisiu” në Durrës është rektorja, prof. dr. Kseanela Sotirofski, dhe prof. dr. Bektash Mema, nga universiteti “Eqerem Çabej” në Gjirokastër, që nuk është prezent.

Të nderuar rektorë, shumë faleminderit për pjesëmarrjen tuaj në këtë mbledhje!

Do të kemi një prezantim shumë të shkurtër nga secili prej jush, nga 5 deri në 7 minuta, dhe, më pas, seancën e pyetjeve dhe të diskutimeve nga kolegët deputetë, anëtarë të këtij Komisioni.

Në mbledhje kemi edhe përfaqësues të dy ministrive, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit është Albana Tole, zëvendësministre e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit; Mirela Bimo, drejtoreshë

e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, ndërsa nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zotin Gentian Opre, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor, dhe zonjën Vilma Çausholli, përgjegjëse e Sektorit të Analizës së Buxhetit Qendror në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor.

Fjalën e ka prof. dr. Skënder Topi dhe më pas, me radhë edhe rektorët e tjerë.

Shumë faleminderit!

Skënder Topi – Përshëndetje, të gjithëve!

Faleminderit, zonja Kushi!

Të nderuar deputetë!

Të nderuar kolegë, përfaqësues të ministrive!

Faleminderit që na jepni mundësinë të diskutojmë! Dëgjothem, apo jo?

I kemi hedhur një sy buxhetit me të gjithë grupin që është për Elbasanin, pra administratorin, specialistët e financës, e kështu me radhë, dhe kemi konstatuar që është një buxhet i mirë, duke parë sidomos dy vitet e fundit. Shumë propozime tonat, që i janë drejtuar qeverisë, janë reflektuar mirë dhe në mënyrën e duhur, por e mira, thotë populli, nuk ka fund.

Për sa i përket këtij buxheti, sidomos për arsimin e lartë, mendoj që janë bërë disa hapa të rëndësishëm jo vetëm në investime në strukturat tona universitare, por edhe për sa u përket projekteve të kërkimit shkencor. Unë do të ndalem në dy reflektime, që mendoj se duhet t’jua sugjerojmë juve dhe strukturave të dy ministrive përkatëse, për shqetësimet që na kanë dalë gjatë këtij viti akademik, por edhe në vitet e shkuara.

Për sa i përket çështjes të parë, mbështetjes studentore, që është edhe “thembra e Akilit”, sipas akteve ligjore e nënligjore të qeverisë, ka dhënë rezultatet e duhura në proceset e regjistrimeve, sidomos në degët prioritare. Qëllimi i vetëm është motivimi i studentëve që të respektojnë dhe të jenë pjesë e këtyre degëve që janë prioritare, por një shqetësim që kemi, duke reflektuar nga ky vit që e po mbyllim, mbështetja financiare mendojmë që duhet të jetë në*(nuk dëgjohet)*.

Për sa i përket vitit 2023, mbështetja financiare për këta studentë që janë mbështetur, studentët me mesatare, ata që janë përjashtuar nga tarifa e kështu me radhë, kapacitetet financiare në mbështetje kanë ardhur në muajin mars. Ky është dhe një ngërç për sa u përket gjithë problematikave që kanë shoqëria shqiptare dhe studentët tanë sot. Mendojmë që për këtë

mbështetje duhet të gjendet një mekanizëm ndërmjet MAS-it dhe MFE-së, që të bëhet në fillimin e vitit akademik. Ky është një sugjerim yni.

Pika e dytë e rëndësishme është kërkimi shkencor. Në këto tri vitet e fundit është bërë një punë kolosale, dhe unë si nënkryetar i konferencës së rektorëve, jam edhe anëtar i bordit të AKSH-it, pranë MAS-it, për sa i përket kërkimit shkencor dhe me zonjën Kushi këto tri vite, kemi ndarë shumë impenjime, kemi bërë goxha punë. Po t'i hedhim një sy buxhetit, në tri vite është rritur me mbi 30%, investimi apo paratë që vijnë nga buxheti i shtetit për kërkimin shkencor jo vetëm në projekte kërkimi, por edhe në infrastrukturë, por kemi një problem shumë të madh, për sa u përket projekteve të kërkimit në infrastrukturë. Me zonjën Kushi, ish-ministre, ne kemi diskutuar shumë herë edhe në bord, por edhe në Komitetin e Politikave, i cili drejtohet nga Kryeministri, për ne si rektorë, shqetësimi i madh është se të gjitha projektet e infrastrukturës, pjesën më të madhe të tyre nuk arrijmë t'i realizojmë brenda dhjetorit të çdo viti përkatës. Pse ndodh kjo? Kjo ndodh sepse ka një procedurë të prokurimit publik dhe unë po ju citoj ligjin nr.162 datë 23.12.2020, nenin 7 që thotë: “Përrjashtimet e veçanta. Pika 1. Shërbimet e kërkimit dhe të zhvillimit, rezultatet e të cilave shfrytëzohen nga të gjithë, përveç rasteve kur përfitimet i shkojnë vetëm autoritetit ose entit kontraktor për përdorimin prej tij për çështjet e brendshme dhe me kusht që shërbimi i kryer të paguhet plotësisht nga ky autoritet ose ent kontraktor”.

Pika 3, “Rastet përjashtimore të parashikuara në pikën 1 rregullohen me akte të tjera ligjore ose nënligjore”. Çfarë dua të them me këtë, duke u konsultuar edhe me ekspertët e financës dhe ekspertët e fushës, pra të jurisprudencës? Të gjitha projektet e kërkimit që ne përcjellim në AKSH, janë projekte të dedikuara dhe me një kontraktor, që janë universitetet, departamentet apo fakultetet. Duke realizuar atë proces që është i ligjshëm, pra prokurimin publik, ne brenda dhjetorit, në 60-70-80% të rasteve, këto fonde i humbim. Çfarë na ndodh? I humbasim, dhe ne si bord me paratë që na vijnë për vitin që vjen, rikuperojmë këto projekte. Do të ishte shumë mirë që nëpërmjet dy ministrive përkatëse, për sa u përket projekteve të kërkimit shkencor, që janë të dedikuara, që miratohen në bordin e AKSH-it, pra nëpërmjet AKSH-it dhe MAS-it duhet gjetur një mekanizëm, që me një vendim bordi, ose me VKM të veçantë, që ne t'i realizojmë këto projekte.

Universiteti i Elbasanit ka fituar një projekt goxha të mirë për një laborator të shkencave mjekësore teknike, kemi tri muaj që bëjmë procedurë, tri muaj që kemi vetëm ankesa, anulohet, rikthehet dhe shpresojmë shumë, por është tepër e vështirë ta realizojmë. Këto janë para të buxhetit të shtetit, që janë vendosur për universitetin, janë fituar nga universiteti, por në këtë situatë janë të

gjitha universitetet, një më pak, një më shumë. Mendoj se ligjvënësit, ministrinë përkatëse duhet të reflektojnë për sa u përket projekteve të kërkimit shkencor në infrastrukturë.

Këto ishin dy propozimet që ne mendojmë se mund të rregullohen.

Dua të them dy fjalë për sa i përket buxhetit, duke mos qenë ekspert, por duke marrë gjithë informacionin e duhur që na keni sjellë. Është një buxhet shumë i mirë. Aty shoh që kërkimi shkencor është në rritje për tri vitet e ardhshme në masën 5-10-15%, të mos bëj ndonjë gabim teknik, dhe ky është një pozitivitet i madh. Po të shikojmë, janë qindra e qindra, para 3-4 apo 5 viteve që flisnim për kërkim shkencor, por nuk kemi bërë kërkim shkencor.

Nëpërmjet këtij fondi që qeveria nga viti në vit e ka rritur, ne po përmirësojmë veten, po rrisim cilësinë dhe po bëjmë projekte më të mira. Universiteti i Elbasanit mbi 80% të stafit akademik e ka të përfshirë në projekte të kërkimit shkencor jo vetëm nga buxheti i shtetit, por me qindra projekte të vogla dhe të mëdha si *capacity-building* dhe projektet “Erasmus”. Pra, sot kemi një realitet tjetër dhe mbështetja e qeverisë për ne është tepër e rëndësishme. Faktin që qeveria i ka kthyer sytë nga universiteti, e shoh me shumë pozitivitet, jo vetëm për rritjen e rrogave, por edhe VKM-në për doktoraturat, aktin e fundit që lidhej me rritjen e rrogave të stafeve administrative dhe ndihmës akademike. Edhe këtu kam një sugjerim tjetër. Për këtë vit akademik sot më informuan se është bërë gati VKM-ja dhe nesër shkon në Ministrinë e Financave, ku do të na rimburohet pjesa për vitin 2023. Pyetja ime është: a është projektuar në buxhet financim për stafin akademik dhe ndihmës akademik për vitin që vjen? Për këtë do të doja një përgjigje nga ekspertët.

Duke ju falënderuar dhe duke ju uruar punë të mbarë të gjithëve, këtu e mbyll fjalën time!

Evis Kushi – Profesor Topi, shumë faleminderit për prezantimin tuaj, për shqetësimet që ngritët dhe për pyetjet që drejtuat!

Do t’u lutesha përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, por edhe të Ministrisë së Financave që t’i mbanin shënim shqetësimet apo pyetjet e ngritura nga rektorët e nderuar, në mënyrë që t’u japim përgjigje! Pra, nga sa kuptova, nga profesor Topi kemi shqetësimin e vonës në procedurat e prokurimit për projektet e infrastrukturës. Me sa e kuptova, ai pyet: a ka ndonjë iniciativë apo ndonjë plan masash për të ardhmen, që të mos ndodhin këto vonesa për të mos e djegur buxhetin? Pyetja e dytë: a është parashikuar apo jo në buxhet për vitin e ardhshëm financimi për stafin joakademik? U lutem përfaqësuesve të dy ministrive t’i mbajnë shënim të gjitha këto pyetje që ngrenë rektorët, që në fund fare t’u japin përgjigje!

Fjala për prof. dr. Rajmonda Kçirën, rektore e universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës.
Zonja Kçira, më dëgjoni?

Në rregull, sa të bëhet gati rektorja e Universitetit të Shkodrës, ia japim fjalën zonjës
Kseanela Sotirofski, rektore e universitetit “Aleksandër Moisiu” të Durrësit.

Mirë se vini, zonja Sotirofski, fjala për ju!

Kseanela Sotirofski – Përshëndetje!

Para se të filloj të flas për Universitetin e Durrësit, dua të falënderoj profesor Topin për
shqetësimet e ngritura, të cilave u bashkohem edhe unë, por besoj se edhe të gjithë rektorët e tjerë!

Unë ju kam dërguar një relacion, me të cilin besoj se jeni njohur, por dua të theksoj disa
gjëra për Universitetin e Durrësit. Universiteti i Durrësit, si gjithmonë, kërkon konviktet, që lidhen
me akomodimin e studentëve, sepse, siç e dini, pjesa më madhe e 18 000 studentëve që ne kemi
aktualisht vijnë nga rrethet dhe nuk janë banues në Durrës. Kjo është një kërkesë dhe një shqetësim
i studentëve dhe do t’ju lutesha që ta merrni parasysh kërkesën tonë për financimin e konvikteve
për studentët e universitetit të Durrësit “Aleksandër Moisiu”!

Për sa i përket buxhetit të këtij viti, ne në çdo zë të buxhetit kemi kërkuar rritje. Në buxhetin
e vitit 2024, të miratuar nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, kemi parashikuar një
buxhet prej 2 miliardë e 174 milionë e 51 mijë lekësh, i cili planifikohet të financohet nga granti,
buxheti dhe të ardhurat e institucionit. Një pjesë të madhe në këtë buxhet e zë ndërtimi i godinës
së tretë të institucionit, i cili është një investim i qeverisë dhe i universitetit, ku jemi në fazën e
parë të zbatimit të këtij projekti dhe do të vijojmë përsëri vitin tjetër me zbatimin e tij. Gjithashtu,
një rritje këtë vit shikojmë në zërin “Kërkimi shkencor”, në të cilin kemi planifikuar 100 milionë
lekë për t’u financuar nga buxheti i shtetit për vitin 2024 për financimin e projekteve kërkimore.
Kjo vlerë është e rritur në krahasim me vitin 2023. Gjithashtu, kemi kërkuar rritje edhe si rezultat
i rritjes së pagave për personelin akademik. Përsëri dua të theksoj atë që tha profesor Topi se ne
kërkojmë që të përfshihen në buxhetin e vitit të ardhshëm, i cili do të na akordohet, edhe pagat e
stafit administrativ. Këto shikoj gjëra të rëndësishme për universitetin tonë. Dua të theksoj se
Universiteti i Durrësit këtë vit ka përfituar konsiderueshëm nga projektet me financim të BE-së
dhe po këtë vit është bërë pjesë e Aleancës së Universiteteve Europiane (i vetmi universitet në
Shqipëri për këtë vit) dhe nga ky program do të përfitojmë shkëmbime akademike, administrative,
studentore dhe programe të përbashkëta studimi. Gjithashtu, këtë vit ne vijojmë të zbatojmë 3
projekte për 3 diplomat e përbashkëta me Universitetin e Krakovit në Poloni, me Universitetin

“Tor Vergata” dhe me Universitetin “La Sapienza”, të cilat janë financuar edhe këtë vit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Dua t’ju falënderoj që na dëgjoni, dhe dua të them edhe njëherë se duhet të marrim masat për vitin e ardhshëm që në këto takime të thërrasim edhe administratorët, sepse, siç e dini, ata janë autoriteti drejtues për pjesën financiare në institucionet e arsimit të lartë.

Faleminderit!

Evis Kushi – Faleminderit, zonja Sotirofski, për prezantimin tuaj dhe për shqetësimet e ngritura! Do të kishim dashur që këtë mbledhje ta kishim zhvilluar me prezencë fizike, madje edhe me prezencën e administratorëve, shumë e drejtë vërejtja juaj, por besoj se i keni ndjekur zhvillimet politike gjatë kësaj periudhe dhe e keni parë se kemi qenë të detyruar, për shkak të bojkotit nga ana e opozitës dhe pamundësisë, për t’i zhvilluar mbledhjet me prezencë fizike, prandaj kemi shfrytëzuar formatin *online*.

Ne shprehim mbështetjen e këtij komisioni për të gjitha universitetet dhe jemi shumë të gatshëm në çdo kohë, jo vetëm me tryeza të zhvilluara këtu, në mjediset e Kuvendit të Shqipërisë, por jemi të gatshëm të vijmë, ashtu sikurse e ka traditë ky komision, edhe pranë mjediseve të universiteteve tuaja dhe t’i shohim nga afër nevojat që ju keni, qoftë edhe për sa i takon nevojës për konvikte, e cila është shumë e drejtë dhe është një kërkesë e vazhdueshme nga pedagogët dhe nga studentët e universitetit të Durrësit “Aleksandër Moisiu”.

Kështu që edhe një herë faleminderit shumë! Besoj se përfaqësuesit e të dyja ministrive i kanë mbajtur shënim dhe, nëse do të kenë përgjigje apo komente më pas, patjetër që janë të lutur t’i bëjnë!

Fjala për rektoren e universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, prof. dr. Rajmonda Kçirën.

Rajmonda Kçira – Përshëndetje!

Faleminderit, që na e jepni këtë mundësi!

Universiteti i Shkodrës i është mirënjohëse Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe Agjencisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin, sepse është mbështetur për të realizuar projekte si: hapja e laboratorit të ushqimit; laboratorit klinik dhe biokimik dhe projektin e edukimit “Çelësi i zhvillimit”.

Dy problematikat, që përmendi profesor Topi, qëndrojnë edhe për studentët e Universitetit të Shkodrës.

E para, studentët i duan më herët pagesat e bursave, të cilat aktualisht kryhen në mars.

E dyta, të krijohet mundësia që tenderimet të kenë hapësirë më të madhe, sepse ka raste që mbeten të parealizuara.

Dua të përmend dy problematika të tjera, të cilat lidhen specifikisht me Universitetin e Shkodrës. Universiteti kërkon mbulimin e një granti, nga granti qeveritar, për një sistem për mbrojtjen nga zjarri, i cili do të rrisë nivelin e sigurisë në ambientet e universitetit. Në fakt, projekti është i gatshëm, unë e kam përcjellë edhe me shkrim, dhe parashikohet të realizohet për 2 vjet.

Një kërkesë tjetër, që paska vite që bëhet, është rikonstruksioni i godinës së rektoratit, e cila gjatë periudhës së sistemit komunist ka funksionuar si godinë e Komitetit të Partisë; është djegur gjatë periudhës së demonstratave dhe, megjithëse i është bërë një rikonstruksion i paktë, ka shumë nevojë për riparime, jo vetëm të brendshme, por edhe në pjesën e jashtme.

Këto janë dy gjërat kryesore që kisha menduar për t'i përmendur në këtë mbledhje. Faleminderit!

Evis Kushi – Shumë faleminderit, zonja rektore!

Nuk e di nëse e kemi në lidhje edhe rektorin e universitetit të Vlorës “Ismail Qemali”, zotin Roland Zisi.

Po, ju lutem, fjala për përfaqësuesin e universitetit të Vlorës, zotin Xhelaj.

Saimir Xhelaj – Përshëndetje!

Unë jam administrator i Universitetit të Vlorës dhe në mungesë të rektorit për arsye personale, i cili më ka autorizuar mua, po marr pjesë në këtë takim. Në këto kushte, jam bërë pjesë e kësaj mbledhjeje për të diskutuar problematikën e cekura edhe më parë gjatë kësaj mbledhjeje nga rektorët.

Në radhë të parë, dua t'i falënderoj të gjithë pjesëmarrësit!

Ashtu si unë, edhe rektori e kemi lexuar projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024”, në dijeninë time, rektori i ka paraqitur edhe një material Kuvendit. Ky projektbuxhet, i lexuar dhe i studiuar nga ana jonë, duket qartë se synon një shpërndarje të fondeve për çdo lloj institucioni, konkretisht fondet e akorduara ose parashikohen t'i akordohen Ministrisë së Arsimit. Vihet re që në këtë buxhet është marrë parasysh kërkesa e universitetit “Ismail Qemali” për parashikimin e fondit të ndërtimit të godinës. Duke qenë se ministria ka marrë përsipër për të financuar rreth 70% të këtij investimi, në zërat e lexuar në tabelat përkatëse rezulton se ministria e ka mbajtur këtë premtim, duke financuar ndër vite pjesën e saj për ndërtimin e kësaj godine. Ashtu sikurse u shpreh edhe profesor Topi, krahas procedurave të prokurimit në kuadër të AKSHI-t, do të shtoja edhe një

shqetësim tjetër: projektet në kuadër të ndërkombëtarizimit. Edhe këto projekte kanë të njëjtën procedurë që, nëse nuk realizohen brenda 31 dhjetorit, janë fonde që mund të digjen. Mosrealizimi i këtyre procedurave nuk shkaktohet gjithmonë për faj të universiteteve, por, në bazë të ligjit “Për prokurimet”, operatorët ekonomikë për çfarëdolloj vendimmarrjeje që mund të marrin komisionet apo anëtarët e komisioneve paraqesin ankesa; paraqitja e ankesave, shqyrtimi i tyre e të tjera i zgjatin procedurat dhe mund të arrijmë që brenda 31 dhjetorit të mund të mos realizohen.

Gjithmonë ministria dhe qeveria i kanë plotësuar dhe i kanë përmbushur kërkesat e universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës për grante, të cilat, me kalimin e viteve, kanë qenë edhe më të mëdha. Gjatë periudhës 2020-2023 kemi qemë fitues në 9 projekte të AKSH-it dhe për periudhën 2021-2023 kemi pasur 2 projekte në kuadër të ndërkombëtarizimit. Aktualisht edhe për këtë vit kemi mbyllur procedurën e ndërkombëtarizimit dhe presim instalimin e pajisjeve që kemi kërkuar. Në përgjithësi do të thosha se jemi shumë dakord me këtë projektbuxhet, i cili pritet të miratohet në vijim.

Faleminderit!

Evis Kushi – Zoti Xhelaj, shumë faleminderit!

Shoh që nuk i kemi në linjë rektorët e universiteteve “Eqerem Çabej” të Gjirokastrës dhe “Fan Noli” të Korçës. Kështu që po ua kaloj menjëherë fjalën përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Më pas, nëse do të duan fjalën përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, menjëherë do të hapim seancën e pyetjeve dhe diskutimeve nga deputetët e komisionit.

Fjala për përfaqësuesit e ministrisë, nëse kanë diçka për t’u përgjigjur apo ndonjë koment shtesë.

Po, zonja Tole.

Albana Tole – Më dëgjoni?

Evis Kushi – Po, ju dëgjojmë.

Albana Tole – Përshëndetje!

Faleminderit, zonja Kushi!

Në radhë të parë, do të doja t’i falënderoja të gjithë rektorët e universiteteve për relacionet e tyre, që shprehën shqetësimet e preokupimet dhe që ngritën një sërë çështjesh, të cilat vlejné të diskutohen edhe në këtë komision, duke iu referuar buxhetit!

Edhe pse disa pika u ripërsëritën dhe u ngritën si çështje nga disa prej rektorëve, unë do t’i trajtoj ato duke nisur nga çështjet e ngritura nga profesor Skënder Topi, rektor i universitetit të

Elbasanit. Në lidhje me çështjen e ngritur për mbështetjen financiare për afatet kohore në të cilat ky buxhet u është dhënë studentëve, do të doja të thosha që fondi për bursat jepet në janar, bashkë me grantin e mësimdhënies. Pra, bursat prioritare kanë disa procedura ekstra dhe kanë në parim disa kushte dhe procedura nëpërmjet të cilave prezantohet kërkesa. Aktualisht është e pamundur që të alokohen fonde në fillim të vitit akademik, pasi fondi për bursat jepet duke filluar nga muaji janar. Pastaj, sipas parashikimeve të VKM-së, ka disa afate kohore për prezantimin e kërkesave nga ana e studentëve, marrjen në shqyrtim dhe më pas akordimin e bursave. Aktualisht është e pamundur, por ne do ta mbajmë në konsideratë kërkesën.

Ndërsa, në lidhje me çështjet e ngritura për rritjen e pagës për stafet, duke iu referuar stafeve administrative, kjo çështje, e cila u ngrit pothuajse nga të gjithë rektorët, është marrë në konsideratë dhe aktualisht kemi një rritje prej 1,3 miliardë lekësh të grantit të mësimdhënies. Kjo kërkesë e adresuar nuk ka ardhur vetëm nëpërmjet kësaj instance, por është diskutuar edhe bashkërisht në komitetin teknik për politikën e arsimit të lartë. Duke thënë këtë, unë do t'ia kaloja fjalën edhe përfaqësueses së Drejtorisë së Financave, zonjës Mirela Bimo, për të bërë disa saktësime në lidhje me çështjet e ngritura nga rektorët.

Ju faleminderit!

Evis Kushi – Po, zonja Bimo.

Mirela Bimo – Përshëndetje!

Ju falënderoj për pyetjet!

Sikurse e përmendi edhe zonja Toke, të gjitha kërkesat për sa i përket shtesës së pagave për personelin akademik dhe atë administrativ janë marrë parasysh, jo vetëm këtë vit, këtë vit në fillim të muajit tetor ne patëm me vendim të Këshillit të Ministrave një shtesë të fondeve prej 300 milionë lekësh, e cila i kundërpërgjigjet kërkesës për rritjen e fondit të pagave për personelin administrativ në të gjitha IAL- të publike, por edhe për vitin 2024 kjo rritje për pothuajse 6 mijë punonjës mësimorë, ndihmësmësimorë dhe akademikë në IAL-të publike do të reflektohet me një shtesë në rritje me një shtesë prej 1,3 -1,4 miliardë lekësh në grantin e mësimdhënies, ku do të përfitojnë të gjithë punonjësit e angazhuar në këtë sistem.

Nëse më lejoni, dua të shtoj diçka lidhur me kërkesën e zotit Topi për çështjet e Agjencisë së Prokurimit Publik, pra për sa u përket vonesave, është e vërtetë që ligji parashikon disa afate kohore, por jo të gjitha IAL-të apo jo të gjitha entet që janë autoritete kontraktore mund t'i realizojnë në kohë këto procedura prokurimi, gjithsesi afatet janë parashikuar në ligj. Ajo që mund

të nxitet nga ana jonë, është që për thirrjet për projekte të reja, si për sa u përket projekteve të ndërkombëtarizimit, edhe për ato të kërkimit shkencor, ministria nga ana e saj do të përpiqet dhe do të punojë për t'i hapur më shpejt aplikimet për thirrje, në mënyrë që universitetet të aplikojnë më shpejt, ta përfitojnë më shpejt financimin dhe kohën në dispozicion për t'i realizuar këto procedura (brenda një periudhe të vitit kalendarik) ta kenë më të gjatë. Nëse do të kërkohen përjashtime nga ligji “Për prokurimet” apo lehtësi të tjera, kjo është e nevojshme që ta diskutojmë edhe me Ministrinë e Financave apo me Agjencinë e Prokurimit Publik, por kjo do të kërkonte modifikime dhe ndryshime në ligjin “Për prokurimin publik”, të cilat marrin kohën e tyre.

Për sa i përket kërkesës për investime në infrastrukturë, mund të themi se pothuajse të gjitha kërkesat që na kanë ardhur nga universitetet, janë reflektuar si në buxhetin e vitit 2023, edhe në buxhetin e vitit 2024, ku janë parashikuar të gjitha projektet që vijojnë nga viti 2023: janë 2 projekte të Universitetit Politeknik, projekti i Universitetit të Elbasanit, atij të Vlorës dhe atij të Durrësit. Kërkesa për konviktet e Universitetit të Durrësit është e drejtë, sepse aty kanë një kampus universitar dhe mungon një konvikt, por dua të nënvizoj që konviktet janë në fushën e përgjegjësisë së bashkive. Ministria e Arsimit financon për akomodimin e studentëve, për rimbursimin e tarifave të akomodimit, ndërsa për sa u përket projekteve të infrastrukturës së konvikteve do të duhet që të koordinohemi me bashkitë për të pasur një planifikim për ta plotësuar këtë kërkesë. Nuk e di nëse lamë diçka pa prekur, por këto ishin pak a shumë përgjigjet.

Evis Kushi – Shumë faleminderit, zonja Bimo dhe zonja Tole!

Zoti Topi, keni një koment?

Skënder Topi – Faleminderit!

Është shumë e vërtetë, dhe zonja Bimo me shumë të drejtë i kaloi me shumë diplomaci problemet e projekteve të kërkimit dhe të infrastrukturës, që janë para të buxhetit të shtetit. Ne kemi insistuar dhe i them zonjës Bimo që nuk varet nga ajo, por besoj se ky komision e ka të gjithë tagrin t'i përcjellë mesazhet në qeveri. Po jap një shembull 30 sekonda: kur, departamentet, fakultetet bëjnë një projekt kërkimi dhe kërkojnë në tavolinë, me këto dimensione, me emër dhe mbiemër, do të thotë që në momentin që shkojnë në procesin e prokurimit publik (dhe zonja Bimo e di shumë mirë, sepse kam pasur një mbledhje të gjatë sot me administratën) e dini që pushtetet janë të ndara, por dhimbjen në fund e kemi në akademikët, në pjesën më të madhe të kohës, 90% e atyre që marrim, nuk marrim çfarë kërkojmë, sepse procesi i prokurimit publik është i tillë, ai vjen me çmim të ulët, vjen nga Hondurasi, nga Kina e kështu me radhë. Prandaj, kjo gjë duhet parë

mirë ose nëpërmjet AKSHI-t, qeverisë, apo ministria të gjejë një mekanizëm që ne, kur bëjmë projekte, të marrim ato që duam, sepse nuk vjen kualiteti, pra porositin laboratorët një gjë tjetër dhe nuk ke hapësirë në asnjë lloj pikëpamje.

Zonja Bimo e di shumë mirë këtë punë. Ne shqetësohemi se, mirë që qeveria na ka rritur mundësinë për të bërë projekte dhe çdo vit fondet për kërkimin shkencor po rriten në një përqindje goxha të madhe, por ne po marrim kualitete të dobëta. Kjo është e vërteta. Pjesën më të madhe nuk e realizojmë dot. Po jua them edhe me të dhëna. Unë kam 2 projekte të AKSH-it që janë hedhur 3 herë, sot jemi zero, pra duhen ribërë nga e para. Janë 320 milionë lekë të vjetër ose 32 milionë lekë të rinj. Nuk është pak për një universitet që buxheti i shtetit të japë një laborator modern, por ne nuk arrijmë do ta marrim, prandaj kjo gjë duhet parë pak me vëmendje. Nuk kemi frikë nga prokurimet publike dhe të bëjmë maskarallëqe, por kjo është situata. Bëhet fjalë për kërkim shkencor. Nëse kërkojmë një gjë dhe e miratojmë në bordin e AKSH-it, atë duhet ta marrim, por nuk e marrim dot. Ky është problemi.

Për sa i përket problemit tjetër, e falënderoj zonjën Mirela, që u zgjidh edhe për vitin 2024, sepse ka pasur një shqetësim nga i gjithë ambienti ynë për sa i përket pagesës nga buxheti i shtetit të ndihmës akademikëve dhe administratës, që është një gjë shumë pozitive. E falënderojmë shumë qeverinë, sepse në mbledhjen e komitetit, që bëmë para disa muajve, insistuam fort dhe për këtë vit u zgjidh, besoj edhe për vitin 2024. Kur e thotë Mirela, mendoj se është kështu. Gjëja tjetër e rëndësishme sa i përket shqetësimit që keni në lidhje me pagesat e studentëve që përfitojnë bursa apo tarifa, nuk kanë ardhur në janar. Studentët janë paguar në mars. Duhet një procedurë bordi prej dy javësh a tre javësh, dhe shkon në prill. Në qershor mbaron shkolla. E vërtetë që ka vështirësi, por ka plot mekanizma që mundësojnë zgjidhje.

Do të cekja edhe diçka sa i përket problemit që ngriti profesoreshë Sianela, në lidhje me konviktet. Unë e kam diskutuar edhe me Kryeministrin para dy a tre viteve, që ky komision ta dëgjojë, dhe zonja Kushi është dëshmitare, që sipas meje, sipas eksperiencës njëzetvjeçare në Europë, është gabim i madh që konviktet nuk janë nën drejtimin e shtetit. Po të marrësh Elbasanin, sot një konvikt ka tridhjetë punonjës, ndërsa po ta drejtojë shteti, atë e mban me pesë punonjës, sepse e ka administrata. E para kjo.

E dyta, të gjitha mobilitetet që kemi, qindra studentë që vijnë nga Europa, sikundër shkojmë edhe ne andej, mund t'i akomodojmë në këto konvikte. Kjo do të thotë të ulen kostot dhe të rritet mundësia për universitetet. Unë e di se është politikë e qeverisë, e bashkive, e kuptoj dhe këtë gjë,

por le ta bëjmë ashtu siç kemi bërë shumë gjëra të mira gjatë këtyre viteve. Le ta diskutojmë, zonja Kushi, edhe me atë Komitetin e Politikave, me Kryeministrin. Kjo me qëllim që të gjendet një mekanizëm, që konviktet të jenë pjesë e universiteteve, pasi ne reduktojmë në masë administratën, rrisim cilësinë e kështu me radhë. Kështu mendoj unë. Pastaj le të vendoset, duke u bazuar në gjithë hapësirën e mundshme ligjore.

Më falni, që ndërhyra, por e pashë të udhës të ndërhyja.

Faleminderit!

Evis Kushi – Faleminderit, profesor!

Unë besoj se të gjitha këto shqetësimet tuaja janë mbajtur shënim, dhe jo vetëm do të jenë pjesë e diskutimit në takimin e ardhshëm të Komitetit të Politikave për Arsimin e Lartë, bashkë me Kryeministrin dhe një pjesë të kabinetit qeveritar, por patjetër që edhe në këtë komision. Jemi shumë të gatshëm të vijojmë diskutimet, qoftë në universitetin tuaj, siç e thashë pak më parë, por qoftë edhe në tryezën e këtij komisioni. Nëse ju duhen ndryshime ligjore apo akte të tjera, ku parlamenti mund të japë kontribut, ne jemi shumë të hapur dhe shumë të gatshëm të japim mbështetjen tonë për t'i zgjidhur, për t'i lehtësuar sa më shumë procedurat për mbarëvajtjen e punëve dhe për realizimin e misionit tuaj.

Tani, menjëherë fjala për kolegët deputetë.

Kush e do fjalën?

Po, zoti Beqiraj, fjala për ju!

Hapeni pak mikrofonin, ju lutem, zoti Beqiraj!

Ismet Beqiraj – Po, më dëgjoni?

Evis Kushi – Po, ju dëgjojmë tani!

Ismet Beqiraj – Përshëndetje edhe një herë!

Përshëndetje të veçantë dhe respekt për profesorët, kolegët tanë të nderuar e të respektuar, në këtë ditë të rëndësishme të vitit, kur po shqyrtohet buxheti ekonomik e financiar për zhvillimin e shoqërisë në tërësi, por edhe të universiteteve. Dëgjesa me ta është kënaqësi, dhe unë i respektoj për planifikimet buxhetore që kanë bërë në institucionet e tyre, duke u treguar realistë edhe në lidhje me nivelin e zhvillimit ekonomik dhe mundësitë që ka shteti. Sinqerisht, unë ndihem i prekur edhe për modestinë dhe delikatesën që tregojnë, duke qenë shumë të kursyer në kërkesa e nevoja, për hir të së vërtetës.

Personalisht, duke qenë se vij nga universiteti, i di hallet e problemet, ndaj bashkoem me të gjitha shqetësimet e tyre. Si në çdo vit buxhetor, sa herë që është diskutuar dhe kemi marrë dëgjesa me rektorët, më kanë pasur në krah dhe do të më kenë në krah edhe nga pozitat e përfaqësimit, si deputet që jam.

Unë desha të bëja disa pyetje, që në vijim do t'ua bëj edhe kolegëve të tjerë rektorë të universiteteve publike, në vijim të shqyrtimit që do të bëjmë. Më konkretisht, duke falënderuar edhe për vlerësimin që i bëjnë qeverisë në lidhje me parashikimin e shumë kërkesave kritike që kanë universitetet dhe zgjidhjet reale që janë bërë. Megjithatë, e mira s'ka fund, shoqëria është vazhdimisht në zhvillim dhe sigurisht që trendi i kërkesave rritet, gjithnjë për të përmirësuar standardin, pasi arsimi është një shërbim publik, sidomos arsimi i lartë... për këtë shërbim është mëndja dhe njësi shumë e rëndësishme e kujtesës, e kulturës, shkencës së një kombi.

Unë do të bëj disa pyetje.

Të nderuar kolegë rektorë, a shfrytëzohet plotësisht autonomia financiare në universitete, në lidhje me të ardhurat, me më shumë të ardhura suplementare, përveç atyre buxhetore? Këtu kam parasysh edhe deklarin që bëri profesor Topi, i cili tha: po, është rritur fondi për kërkimin shkencor, kemi marrë pjesë dhe kemi shumë projekte.

Jam plotësisht dakord edhe me atë pjesë që kërkoi ndryshim, që të ketë edhe akte nënligjore për t'i lehtësuar, që të mos i pengojë administrativisht në realizimin e projekteve të ndryshme shkencore, sepse edhe projektet shkencore kërkojnë financim që të japin produktin final. Sepse përveç buxhetit, këto të ardhura suplementare do të jenë edhe një rezervë financiare për rritjen e rrogave dhe shpërblimeve në universitet, jo vetëm për mirëpagimin e pedagogëve të brendshëm, por dhe të atyre të jashtëm e të ftuar. Në lidhje me këtë unë kam një pyetje të veçantë: ashtu sikurse janë rritur dhe duhet të rriten pagat e pedagogëve në tërësi, edhe të administratës, po për këtë pjesë a është parashikuar? Sepse ka mbetur një vendim i hershëm. Sinqerisht, po të krahasohemi me kolegët tanë në Kosovë, raporti është një me katër. Gati dhjetë euro paguhet një profesor dhe një profesor i asociuar në Shqipëri, ndërkohë që rreth 30-40 euro paguhet në Kosovë.

Pyetje tjetër, lidhur me rritjen e kërkimit shkencor, pasurimin me laboratorë kudo, por sidomos në shkencat teknike. Mbase në universitetet tuaja nuk ka, por ne kemi universitete dhe fakultete, që një problem më të madh, edhe në respekt e në zbatim të Kodit të Punës, kanë koeficientin e vështirësisë për kushtet e vështira e të rrezikshme për ata që punojnë në sektorë si kimia, fizika, biologjia, mjekësia, por besoj se edhe në degë specifike që kanë universitetet tuaja.

Thënë në mënyrë më të përmbledhur, sa për qind zënë të ardhurat e universitetit, në raport me planifikimin buxhetor?

Edhe një pyetje tjetër, që desha t'ju bëja, duke parë edhe objektivat që ka dhe synon financimi buxhetor deri në vitin 2026, që raporti mesatar student-pedagog për tre ciklet e studimit të arrijë në 17. Duam, s'duam ne, kjo do të thotë se aktualisht universitetet janë të mbingarkuar edhe me pedagogë të jashtëm e të ftuar. Do të ishte me interes të dinim se sa është ky raport, dhe a janë parashikuar në buxhetet tuaja, sepse nuk e dëgjova dhe dua ta di? Në Fakultetin e Shkencave, në Universitetin e Tiranës, pak a shumë e di, por dua ta di realisht edhe në lidhje me universitetet tuaja. Këtë zë e keni planifikuar apo jo? Sa u takon pedagogëve të jashtëm e ata të ftuar – e unë ia mëshoj këtu – nëse për universitetin raporti është i madh, kjo ndodh nga pamundësia e rekrutimit nga ana juaj, sepse pedagogu i jashtëm nuk merr sot pothuajse as 50 % të rrogës mujore për një vit, në raport me një pedagog të brendshëm aty?

Këto pyetje kisha.

Evis Kushi – Zoti Beqiraj, faleminderit!

Nuk e di nëse ndonjëri nga rektorët ka dëshirë të përgjigjet. Nuk e di, mbase zoti Topi apo zonja Kçira.

Profesor, keni diçka për të thënë?

Po, ju lutem, fjala për ju!

Skënder Topi – E falënderoj profesorin, por a ka mundësi ta ketë edhe mikrofonin hapur profesori, nëse është e mundur, që të bëjmë një debat të vogël.

Profesor, të falënderoj shumë për pyetjet që bëre, janë të gjitha legjitime, por ua ke drejtuar personave të gabuar! Sepse, ju dini shumë mirë që prej shtatë vitesh e pak – ne mund t'ua japim të dhënat që kërkon, por s'jemi të saktë në të dhëna – pushtetet janë të ndara. Pushteti i rektorit është bërë në strategjinë e arsimit të lartë. Pushtetin ekonomik e ka administratori, bordi, e në universitetet tona është në mazhorancë qeveria, dhe struktura që varet nga administratori.

Unë mund të jap ca përgjigje, sepse kam gjithë informacionin e duhur për të dhënë përgjigje. Po e filloj nga pyetja e fundit, sa i përket problematikës që ju ngritët, raporti staf akademik i brendshëm dhe i jashtëm. Është e vërtetë, ka një problem. Universiteti i Elbasanit nuk e ka këtë problem, por në të gjitha universitetet ky problem qëndron. Mendoj se me kalimin e viteve, këto vitet e fundit, po të shikoni strukturat e universiteteve publike kanë shumë vende bosh, të pazëvendësuar me stafe akademike të brendshme. E kemi merakun e departamenteve, sepse

bie numri i studentëve. Në lidhje me numrin e studentëve, strukturën që është bërë para dy-tre viteve, në gjithë universitetet tona nuk e kemi realizuar 100 %, me strukturë të brendshme dhe efektive. Ky ka qenë dhe një motiv. Dhe bëmë mirë, sepse sot jemi para një situatë, që me programin që mendonim të arrinim para tre-katër viteve, pra në rritje të numrit të stafit, duke u rrit edhe numri i studentëve, ka ndodhur e kundërta. Kemi reduktim të numrit të studentëve, kemi mbylljen e disa degëve, që duan 3 vjet, por janë me nga 4, 5, 6, 7, 8 apo 10 studentë. Ky ka qenë një motiv që ne mendojmë ta rregullojmë brenda dhjetorit bashkë me strukturat, duke e ulur më shumë raportin efektiv të jashtëm, pra më pak të jashtëm. Ky është një ndër motivet, që besoj e kanë të gjithë IAL-të publike.

Ka edhe një problem tjetër, profesor, është shumë e vështirë sot të rekrutosh, pra sistemi ynë ka shumë pak elementë, sepse hapim konkurse, sidomos në degët prioritare, si: fizikë, matematikë, biologji-kimi, i kemi shpallur konkurset nga 3-4 herë dhe nuk kemi kandidatë që të plotësojnë kriteret.

Po të kthehem pak mbrapsht, besoj se në vija të përgjithshme e ezaurova pyetjen e fundit.

Sa i përket problematikës së autonomisë, kemi autonomi, por jo ndonjë autonomi të madhe, sepse thuhet me të madhe ‘autonomi universitare’, aq sa, i dashur profesor, rektori, dekani apo departamenti nuk ka hapësirë ligjore që të blejë një kafe, edhe kafën, edhe ujin e blen vetë, që ta bëjmë banale fare, sepse duhet bërë tender edhe për 100 mijë lekë të vjetër apo për 500 mijë lekë të vjetër, pa menduar pastaj të gjithë problematikën e ndërkombëtarizimit. Tek të gjitha universitetet ka delegacione që ikin e vijnë në Shqipëri dhe këto kërkojnë një procedurë të jashtëzakonshme pritjeje dhe përcjelljeje. Edhe një biletë duhet bërë me tenderim, madje edhe një drekë apo një darkë, sepse vijnë 5 veta nga Europa dhe duhet t’i presësh. Edhe këto janë problematika. Pra, kemi autonomi, por duhet parë në themel për ta kuptuar si e jetojmë ne.

Sa i takon problemit tjetër, të ardhurave e të tjerë me radhë, mendoj se duhet bërë një takim me administratorët, që të kemi një informacion më të saktë, me shifra, jo se ne nuk jemi në dijeni, por unë nuk jam në gjendje tani ta jap përgjigje të saktë, me të dhëna, me shifra me data, se jam para një komisioni të nderuar parlamentar.

Ne jemi të gatshëm, po të na jepni një kohë të dytë, që t’ju japim të gjithë informacionin që doni, se e kemi të gjithë strukturën në dispozicion.

Shumë faleminderit!

Nuk mendoj se lashë ndonjë gjë pa përgjigje, u mundova të jem sa më i thjeshtë dhe korrekt.

Evis Kushi – Profesor, shumë faleminderit!

Ishit shumë i qartë dhe shumë i detajuar në përgjigjet tuaja.

A ka nevojë për të ndërhyrë rektorja e universitetit të Shkodrës?

Rajmonda Kçira – Profesori përmendi fillimisht raportin e orës së mësimit në Shqipëri dhe në Kosovë. Unë mendoj se kjo duhet të jetë pak e orientuar, sepse janë fikse dhe ne nuk mund të lëvizim me pagesat, ndërsa koeficienti i vështirësive duhet parë, por nuk e di sa ka në dorë institucioni. Kështu që, mendoj se duhet parë nga instancat e tjera, sidomos ora e mësimit, që, faktikisht, nuk ka lëvizur, ka lëvizur pagesa, por jo pagesa për një orë mësimi; ende ecim me standardet e mëparshme.

Evis Kushi – Faleminderit, zonja rektore!

Zoti Beqiraj kërkon fjalën.

Ju lutem, në mënyrë të përmbledhur, sepse kemi orarin për mbledhjen e dytë.

Ismet Beqiraj – Patjetër!

Faleminderit për përgjigjet!

Po e filloj me profesor Topin.

Të them të vërtetën, një pjesë e këtyre problemeve të universiteteve ju nuk i prekët, gjë që e thashë edhe në parantezë. Sinqerisht, unë e trajtova këtë problematikë. Gjithsesi, edhe nëse ka ndonjë fakultet ose ndonjë departament të veçantë, që merret me edukimin teknik, që është më i specifikuar, ky është shqetësimi im.

Unë pyetjet i kam më shumë incentivuese, që ju të kërkonit, t'i nxisni në këtë drejtim (dakord, u bë një përmbysje e pagave dhe jam plotësisht dakord me shqetësimin tuaj, është më se i drejtë, sidomos rekrutimi i pedagogëve të rinj në universitete), që për pedagogët *part time* ose për pedagogët e ftuar, ashtu siç ndryshoi vlerësimi i tyre, pra ora akademike, duhet të ketë një shpërblim dinjitoz. E di që këto nuk i vendosni ju, por as koeficientin e vështirësisë nuk e vendosni dot ju, që t'i përgjigjem edhe koleges Rajmonda, ama kjo duhet të kërkohet në institucionet përkatëse dhe të ketë një zë të veçantë në buxhet, sepse doni apo nuk doni, ky është raporti.

E dimë që e ka bordi këtë punë, por ju kur vini për të raportuar, e bëni në emër të institucionit, dhe unë e quaj të ezauruar edhe rolin e bordit. Edhe ndryshimi i këtyre tarifave le të bëhet brenda suazës së buxhetit të çdo institucioni dhe të të ardhurave.

Si duhet trajtuar personeli ndihmës mësimor, pa të cilin pedagogët nuk mund t'i udhëheqin studentët, qoftë në praktika apo në laboratorë, pra pa laborantët? Ai është ndihmës mësimor me

ligj, njëlloj si një punonjës i thjeshtë i një administrate formale në pagesa? Jo, këtë e kisha më shumë për nxitje. Kërkesat tuaja, edhe në këtë dëgjese të sotme, unë i quaj modeste, jua thashë që në fillim. Pra, anoj nga ju dhe ju mbështes me zërin e përfaqësuesit që kam në Kuvend.

Ju faleminderit!

Evis Kushi – Zoti Beqiraj, shumë faleminderit!

Këtu e mbylлим këtë pikë të parë të rendit të ditës, duke falënderuar shumë të gjithë rektorët e universiteteve të rretheve, si dhe përfaqësuesit e ministrive, që do të vazhdojnë të jenë në mbledhje për pikën e dytë të rendit të ditës, që është seancë dëgjimore me rektorët e universiteteve publike të Tiranës për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

Edhe një herë shumë faleminderit rektorëve që i kishim në pjesën e parë të mbledhjes!

Faleminderit!

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2023, ora 14:00

Drejton mbledhjen:

Evis Kushi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Seancë dëgjimore me rektorët e universiteteve publike të Tiranës për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

Marrin pjesë:

Evis Kushi, Lindita Buxheli, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Ilir Topi, Ilir Metaj, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Eslemvera Zake, Meri Markici, Ina Zhupa, Kastriot Piroli, Eralda Bano, Merita Baku, Orjela Nebijaj dhe Ismet Beqiraj (zëvendësues).

Mungojnë:

Flutura Aça, Petro Koçi, Andia Ulliri dhe Agron Gjekmarkaj.

Të ftuar:

Prof. dr. Artan Hoxha - rektor i Universitetit të Tiranës,

Prof. dr. Arben Gjata - rektor i Universiteti të Mjekësisë,

Prof. dr. Fatbardh Sallaku - rektor i Universiteti Bujqësor të Tiranës,

Albana Tole – zëvendësministre e Arsimit dhe Sportit,

Mirela Bimo - drejtore e Financës dhe Buxhetit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit,

Gentian Opre - drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,

Vilma Çausholli - përgjegjëse e Sektorit të Analizës së Buxhetit Qendror në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Evis Kushi – Atëherë, vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: seancë dëgjimore me rektorët e universiteteve publike të Tiranës për diskutimin në parim të projektligjit "Për buxhetin e vitit 2024".

Të pranishëm në mbledhje në formatin *online*, kemi rektorin e Universiteti të Tiranës, prof. dr. zotin Artan Hoxha; rektorin e Universitetit të Mjekësisë, prof. dr. zotin Arben Gjata dhe rektorin e Universitetit Bujqësor të Tiranës, prof. dr. zotin Fatbardh Sallaku.

Të nderuar rektorë, shumë faleminderit!

Ne, përveç deputetëve, anëtarë të këtij komisioni, kemi në mbledhje edhe përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, konkretisht zëvendësministren, zonjën Albana Tole, dhe drejtoreshën e Financës dhe Buxhetit, zonjën Mirela Bimo. Gjithashtu, kemi përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zotin Gentian Opre, drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, si dhe zonjën Vilma Çausholli, përgjegjëse e Sektorit të Analizës së Buxhetit Qendror në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor.

Mbledhjen e kemi organizuar në një format të tillë, ku secili prej rektorëve bën një prezantim të shkurtër të buxhetit, të risive, por edhe të shqetësimeve dhe problematikave që kanë në lidhje me këtë buxhet. Më pas, përfaqësuesit e ministrisë do t'u përgjigjen shqetësimeve dhe, në fund, deputetët, anëtarët e komisionit, mund të drejtojnë pyetje, por mund të bëjnë edhe komente apo diskutime në lidhje me projektligjin e buxhetit.

Si fillim po ia jap fjalën rektorit të Universitetit të Tiranës, zotit prof. dr., Artan Hoxha.

Profesor, shumë faleminderit!

Mirë se keni ardhur në komision!

Fjala për ju.

Artan Hoxha – Faleminderit për ftesën, zonja Kushi!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Të nderuar kolegë,

Ne ndodhemi në të njëjtën situatë, si çdo vit tjetër, me këtë projektbuxhet, i cili, për hir të së vërtetës, ka një rritje krahasimisht me buxhetin e vitit të shkuar, flas për buxhetin tërësor, sepse ai pastaj shpërndahet nga Ministria e Arsimit.

Ne kemi të njëjtën problematikë që kemi thënë vazhdimisht, mungesën e dokumentacionit paraprak zyrtar për projektligjin në drejtim të institucioneve të arsimit të lartë. Kjo do të thotë që ne sot nuk kemi një informacion lidhur me projektbuxhetin e paraqitur nga e Ministria e Arsimit në Këshillin e Ministrave. Ne kemi vetëm, si të thuash, atë projektbuxhet total që ka përpunuar Këshilli i Ministrave për t'ia paraqitur Parlamentit. Domethënë, ne nuk e dimë se si është përpunuar ky projektbuxhet dhe çfarë ka pastaj si elemente, që i krahason me projektbuxhetet e mëparshme dhe me kërkesat që institucionet e arsimit të lartë kanë. Pra, sipas të dhënave që ne kemi propozuar çdo vit formulohet projektbuxheti vjetor, por ne nuk e dimë si është, për të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe së bashku ato janë prezantuar nga Ministria e Arsimit drejt Këshillit të Ministrave. Më pas projekti përfundimtar i Këshilli i Ministrave i propozohet Kuvendit të Shqipërisë dhe vendoset për diskutime nëpër komisione, sikurse është edhe kjo e ditës së sotme. Pra, këtu duhet rregulluar procedura, pasi ne duhet të dimë paraprakisht në nivel të arsimit të lartë, sepse këtu vjen në total, se cili është propozimi i Ministrisë së Arsimit dhe cili është propozimi pastaj fundor, që vjen nga Këshilli i Ministrave dhe këto institucione nuk duhet ta bëjnë arsimin e lartë pjesë të procesit në përfundim të procesit.

Kjo është vërejtja që e kemi thënë edhe në vitet e shkuara dhe vazhdon të mbetet një problematikë dhe ne mbetemi thjesht përpara shifrave. Pra, duke qenë të shpërndara, ne si institucione, konkretisht unë si rektor i Universitetit të Tiranës apo edhe kolegët e mi të universiteteve të tjera, nuk e dimë se sa është buxheti që do të miratohet për ne, për shkak se, pasi të miratohet buxheti i përgjithshëm i arsimit të lartë, atëherë bëhet edhe ndarja e tij mes institucioneve individualisht, por kjo nuk bëhet nga Kuvendi i Shqipërisë, por nga Ministria e Arsimit. Pra, unë, si kryetar i Konferencës së Rektorëve, nuk e di se cili është buxheti që ne të gjithë bashkë kemi propozuar dhe cili është buxheti që është transplantuar ose jo nga Ministria e Arsimit drejt Këshillit të Ministrave. Lidhur me këtë ajo që unë dua të t'i vë në dukje komisionit është se duhet mbajtur shënim që kjo procedurë të jetë më e hapur, më transparente dhe më gjithëpërfshirëse.

Nuk është serioze që ne këtë kërkesë e bëjmë çdo vit dhe çdo vit jemi përpara së njëjtës situatë. Është tjetër gjë çfarë nevojash kemi ne dhe sa është në gjendje qeveria t'u përgjigjet këtyre nevojave dhe është tjetër gjë procedura e hartimit të projektbuxhetit të institucioneve të arsimit të lartë. Duke u bërë në mënyrë të rregullt është edhe mundësia që ne të kuptojmë më shumë, edhe

të reagojmë më mirë, por edhe projektbuxheti, që transformohet në buxhet më pas, të jetë sa më afër nevojave dhe realitetit që ka arsimit të lartë në Shqipëri.

Po të shikosh për nga pikëpamja e prodhimit të brendshëm bruto, ne pak a shumë mbetemi në të njëjtin nivel si me vitin e shkuar, nga 3,32% me 3,20%, pra ka një ulje, por duke u bashkuar me fondet për shkencën buxheti i sivjetshëm është 3,59%, sipas llogarive tona, të GDP-së. Vitin e shkuar ka qenë 3,62%, parvjet ka qenë 3,50% dhe në vitin 2021 ka qenë 3%. Pra, ne kemi arritur në rritje, por krahasimisht nga viti i shkuar me këtë vit ka një ulje të vogël në 0,4%, por që në thelb në vlera absolute është gati 19 milionë e 500 mijë euro më shumë, pasi vetë buxheti i shtetit nga 3 miliardë e 300 e ca milionë sot është gati 4 miliardë euro. Kjo do të thotë që edhe pse është rritur në shifra absolute, përsëri në raport me PBB-në ka një ulje të vogël në raport me vitin që shko.

Ajo që ne nuk arrijmë dot të kuptojmë është se në këtë rritje prej 19 milionë e 500 mijë euro, çfarë ka ndikuar apo çfarë është përfshirë? A është përfshirë rritja e pagave? Pra, këto para shkojnë për paga dhe sigurime shoqërore apo janë kontribute të tjera, që vijnë në ndihmë të arsimit të lartë? Në mungesë të këtij informacioni, kësaj mund t'i bihet edhe me një vizë, sepse ne nuk i dimë nevojat që kanë institucionet e tjera publike të arsimit të lartë, se po t'i dinim, do ta kishim dhënë përgjigjen, që këto mund të jenë një kalkulim i rritjes në buxhetin e shtetit dhe fondit të pakushtëzuar për sa i përket rritjes së pagave që ka pasur personeli akademik, ndihmësakademik dhe administrativ.

E thënë kështu, atëherë ne nuk e dimë se cilat janë sfidat e reja që kanë të bëjnë me arsimin e lartë dhe se si ato mbështeten nga Këshilli i Ministrave me fonde buxhetore.

Në relacionin e ministrisë flitet për ndërtimin e kampuseve, që është një financim i 80 apo 100 projekteve me donatorë të huaj, në kuadër të mbështetjes së kërkuesve të rinj që kanë të bëjnë me kampuse në disa institucione të arsimit të lartë. Nuk jam i sigurt nëse këto janë parashikuar në buxhetimin e Ministrisë së Arsimit, janë parashikuar në buxhetimin e Bashkisë së Tiranës apo nuk janë buxhetuar fare. Ato janë përmendur, por po të shikosh rritjen e vlerës prej 19 milionë e 500 mijë, pra po të mbetemi këtu, atëherë nuk mendoj se në buxhetin e vitit 2024 janë parashikuar kampuset dhe rindërtimet në disa institucione të planifikuara të arsimit të lartë, siç janë: Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave, Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Teknike në universitetin e Elbasanit, në universitetin e Durrësit, kampusi i Universitetit të Tiranës, si dhe të gjitha rindërtimet e godinave apo rikonstruksionet e disa godinave. Kjo gjë, si rektor i Universitetit të Tiranës, më vendos përpara pyetjes: a është parashikuar në buxhetin e vitit 2024 infrastruktura e Universitetit

të Tiranës, si institucioni i arsimit të lartë më i madh në vend, që në gjithë këto vite ka marrë nuk ka marrë vëmendjen e nevojshme për sa i përket infrastrukturës, jo çështjeve të tjera?

Nevoja për fillimin e punës së një kampusi të ri në Universitetin e Tiranës, sikurse është projektuar dhe ka vite që po diskutohet, është një domosdoshmëri jetike për të zhvilluar shumë procese, që i ka në vazhdimësi dhe që i ka të projektuara në kuadrin e transformimeve dhe sfidave që arsimit të lartë ka. Lidhur me këtë, ndoshta nga përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, do të doja një përgjigje konkrete, sepse të gjithë duam të dimë se ku jemi me financimin e infrastrukturës në Universitetin e Tiranës, pasi disa financime të tjera janë planifikuar. Për ne si universitet disa financime janë më rëndësishme në raport me disa të tjera, pasi përballemi me sfida të rëndësishme për të mbajtur arsimin e lartë në ato nivele që kërkohen në kuadrin e zhvillimeve brenda vendit, por edhe zhvillimeve në hapësirën e BE-së. Pra, është e nevojshme që këto sfida të mbështeten me financime që janë të domosdoshme dhe që ndikojnë thelbësisht në performancën e universitetit më të madh në vend.

Kjo ishte për sa i përket pjesës për Universitetin e Tiranës dhe duke folur si kryetar i Konferencës së Rektorëve ne mbetemi në problematikën, që ky proces për institucionet e arsimit të lartë vjen vetëm në momentin fundor. Kjo nuk është as gjë e mirë dhe nuk e ndihmon as buxhetimin e arsimit të lartë. Nuk ka rëndësi nëse qeveria i ka paratë apo jo, por ajo që ka rëndësi është se ky proces duhet të jetë transparent dhe ne të dimë se si komunikohet dhe se si propozohen interesat në fusha të caktuara, duke marrë në konsideratë që arsimit në përgjithësi dhe arsimit të lartë në veçanti janë interesa kombëtare dhe nuk janë interesa as të vetë arsimit dhe as të institucioneve të arsimit të lartë.

Kemi të konstatuar pozitivisht rritjen e përqindjes së financimit për disa zëra ku ne shkojmë në garë, pra nuk iu përcaktohen drejtpërdrejtë institucioneve dhe kjo është një gjë e mirë, pasi i vendos institucionet e arsimit të lartë në garë me njëri-tjetrin që të fitojnë projekte. Këtu futen projektet e infrastrukturës, kërkimit shkencor dhe të ndërkombëtarizimit. Ka një rritje të buxhetit në një tendencë për të shkuar në një përqindje në vitin 2030 në këtë mbështetje buxhetore, por, gjithsesi, këto janë pak për nevojat që institucionet e arsimit të lartë kanë.

Ky buxhetim, në mënyrë konkrete, neve na përkthehet në paga dhe në sigurime shoqërore për personelin dhe për punonjësit, që vjen me fondin e pakushtëzuar të qeverisë, pavarësisht zërave që ai përmban brenda, por në vlerë absolute neve na shërben vetëm për të paguar personelin tonë. Të gjitha proceset e tjera ne i bëjmë me burime të tjera financimi dhe jo nga buxheti.

Faleminderit!

Evis Kushi – Profesor, shumë faleminderit për të gjitha shqetësimet që ngritët dhe që unë jam e sigurt se përfaqësuesit e Ministrisë i kanë mbajtur shënim; ndoshta do të kenë mundësi të japin një përgjigje apo komente rreth tyre!

Unë besoj se, në bashkëpunimin ndërmjet universiteteve dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe qeverisë në përgjithësi, shumë shqetësime mund të zgjidhen, për më tepër që tani është funksional edhe Komiteti për Politikën e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor. Pra, kjo është një çështje që mund të trajtohet. Gjithsesi ne, si Kuvendi i Shqipërisë dhe si Komision parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, do të japim kontributin tonë për t'ju ndihmuar brenda mundësive, në mënyrë që shqetësimet që ju keni të adresohen sa më parë.

Megjithatë, pasi ta marrin fjalën profesor Gjata dhe profesor Sallaku, përfaqësuesit e ministrisë do të japin një përgjigje. Për ta adresuar këtë shqetësim, sigurisht që duhet shumë kohë, ndaj bëhet fjalë që të adresohen në buxhetin e vitit të ardhshëm, sepse ky buxhet po shqyrtohet në Kuvendin e Shqipërisë. Pra, besoj se ky shqetësim, që u ngrit vitin e ardhshëm, nuk do të përsëritet më.

Fjala për profesor Gjatën.

Arben Gjata – Përshëndetje!

Faleminderit! Është kënaqësi t'ju shohim, pavarësisht se jemi në distancë, sepse kohët e fundit jemi parë disa herë.

Gjithashtu, dua t'ju falënderoj për të gjithë kontributin që keni dhënë si ministre e Arsimit, në drejtim të ecurisë pozitive që ka pasur arsimit i lartë gjatë viteve që keni qenë ministre!

Faktikisht, dua të ngre dy çështje. Njërin nga çështjet e kemi ngritur gjithmonë, por, siç tha edhe rektori i Tiranës, ne nuk e dimë se sa do të jetë fondi për vitin tjetër. Në projektbuxhetin afatmesëm, mes të tjerave, kemi planifikuar edhe rikonstruksionin e një godine, që është dëmtuar nga tërmeti. Në projektin e kemi gati, por, edhe pse u bënë kaq vjet, rikonstruksioni nuk ka filluar akoma. Bëhet fjalë për projektin e godinës së farmacisë dhe shëndetit publik. Studentët mësimin e zhvillojnë në ambiente të tjera, por, me rritjen e numrit të studentëve në Fakultetin e Mjekësisë dhe në mjekësi në përgjithësi, ne jemi ngushtë me ambiente, sepse kemi këtë godinë të universitetit që është jashtë funksionit.

Ne si universitet kemi pasur para, por ato para nuk janë të Fakultetit të Mjekësisë, por të një fakulteti tjetër, ndaj është pamundur shfrytëzimi i atyre parave për të rikonstruksionin e kësaj godine.

Kërkesa tjetër që kemi ngritur këtë vit, nuk e di nëse do të aprovohet apo jo, ne jemi duke aplikuar me CEB-in, Bankën e Komunitetit Europain për Zhvillim, për krijimin e qendrës së biosimulimit kimik, për të cilën, gjithashtu, e kemi projektin gati. Faktikisht, ne i kemi çuar të gjitha materialet e projektit që na kanë kërkuar dhe si proces e di që është në bordin e drejtorëve në Bruksel. Shpresojmë që të aprovohet! Kjo qendër moderne e Universitetit të Mjekësisë do të ndërtohet atje ku sot është spitali nr. 1. Me Ministrinë e Shëndetësisë është rënë dakord që atëherë dhe vazhdon të jemi dakord që të përdoret ajo hapësirë për ndërtimin e kësaj godine, e cila e mbyll komplet QSUT-në.

Problemi tjetër është, e tha edhe Tani, se ne nuk jemi në dijeni se sa fonde do të kemi. Çfarë ndodh? Ndodh që këto fonde nga projektbuxheti do të vijnë në janar. Në janar do të bëhet rishikimi i projektbuxhetit që kemi bërë për vitin tjetër. Ky projektbuxhet duhet të kalojë në bord, duhet të kalojë fillimisht nëpër fakultete, pastaj duhet të kalojë në senatin akademik, pastaj do të kalojnë në bordin e administrimit. Afati më i mirë që mund të arrijmë të mbyllim projektbuxhetin e vitit tjetër, pra të jetë i gatshëm për zbatim, i bie të jetë shkurti, por nganjëherë shkon deri në mars, se mund të ketë edhe vonesa ose problematika të ndryshme. Periudha për prokurime mbetet marsi, prilli, maji, qershori, korriku, gushti, shtatori, tetori deri më 15 nëntor, pra mbeten 8 muaj e gjysmë. Nëse në këta 8 muaj e gjysmë llogarisim prokurimet, ankimimet, APP-të KPP-të, vonesat e histori të tjera, ne vazhdojmë të kemi problem të madh realizimin e investimeve në nivele shumë të ulëta, pikërisht edhe për shkak të kësaj.

Ne e kemi propozuar disa herë, por nuk e di, ndoshta edhe ju e keni çuar zërin te Komisioni i Ekonomisë, mbase duhet bërë edhe një ndryshim ligjor, që universitetet, duke qenë se trashëgojnë fonde, do të ishte mirë që të kishin mundësi t'i vazhdonin prokurimet edhe pas datës 15 nëntor, sepse, po kaloi data 15 nëntor, ne nuk bëjmë dot asnjë prokurim. Madje, vjet, në dhjetor, kur kishim 70-vjetorin e universitetit, nuk bënim dot prokurimet për biletat që do të merrnin të ftuarit nga jashtë dhe gjetëm donator. Pra, kishim para, por nuk kishim mundësi të prisnim bileta dhe të siguronim akomodimin e të ftuarve. Kjo çështje ka 4-5 vjet që është ngritur edhe në komisionin tuaj, edhe në Komisionin e Ekonomisë, por faktikisht nuk është gjetur një zgjidhje ligjore. Pra, duhet gjetur një mundësi apo të krijohet një urë që ne të vazhdojmë me prokurimet që kemi me

buxhetin e vjetër derisa të prodhohet buxheti i ri, se vendosemi para disa ngërçeve që nganjëherë janë problematike.

E kuptoj që nuk është çështje e rektorit që të merret me prokurimet publike, por, kur nuk realizohen prokurimet publike, kjo çështje bëhet e rektorit, sepse mungojnë investimet që duhen bërë për të përmirësuar infrastrukturës, kushtet e studentëve e të tjera.

Unë këto dy pika kisha. Pra, jam shumë dakord me atë që tha Tani që ne duhet të kemi një informacion të përgjithshëm për projektbuxhet para se Ministria e Arsimit ta kalojë në komisione për shqyrtim. Pra, ne i çojmë projektbuxhetet që kemi, por nuk e dimë se sa për qind e këtij buxheti aprovohet, ndaj do të ishte mirë që të kishim një informacion paraprak, para se të kalojë në komisione, në mënyrë që edhe ne të përgatitemi më mirë për infrastrukturën e vitit të ardhshëm.

Faleminderit shumë dhe suksese!

Evis Kushi – Profesor, shumë faleminderit!

Menjëherë pas fjalës së profesor Sallakut, përfaqësuesit e Ministrisë do t’u përgjigjen pyetjeve tuaja.

Profesor Sallaku, është kënaqësi dhe faleminderit që jeni këtu!

Fjala është për ju.

Fatbardh Sallaku – Faleminderit!

Nuk dua ta përsërit profesor Gjatën, por është kënaqësi që shihemi!

Keni vlerësimet maksimale nga ana jonë, sepse vërtet kemi kaluar një periudhë shumë *soft* (kemi pasur nevojë), ndaj na vjen mirë që ju shohim përsëri dhe në krye të këtij komisioni.

Gjithashtu, faleminderit, të gjithëve për kohën!

Unë dua ta nis me falënderime dhe mirënjohje për stafin e Ministrisë së Arsimit, se është mirë të thuhet fjalë të mira kur bëhet fjalë për fakte.

Meqenëse profesor Hoxha bëri një rezyme për të gjitha problematikat e universiteteve, unë nuk po i përsërit që të kursejmë kohën.

Dua t’ju falënderoj që na keni rritur rrogat! Shumë faleminderit!

Duhet të dini që rrogat në universitet janë bërë kompetitive, një pozicion është bërë shumë kompetitiv, që do të thotë se është gjëja më e rëndësishme që kemi arritur në këto ditë, pavarësisht pritshmërive tuaja ndaj stafit apo pritshmërive tona ndaj stafit, kjo është çështje tjetër që vlen të diskutohet.

Nga ana tjetër, faleminderit, sepse që në fillim të janarit kemi pasur mundësinë të kemi informacion për pagat! Pra, ne e dinim se sa na keni mbuluar, që do të thotë se është hequr një dhimbje koke. Unë kam 30 e ca vjet në universitet dhe ka pasur vite kur universitetet kanë marrë 9 deri në 10 muaj rroga dhe pjesa tjetër merrej nga të ardhurat. Pra, shumë faleminderit stafit të ministrisë! Mirela ka qenë shumë gjeneroze ne këtë mes, ndaj e falënderoj shumë!

Unë po them ato që unë mendoj për universitetin që përfaqësoj, pastaj ju vendosini vetë për prioritetet. Nuk është e re, e kam thënë vjet apo parvjet, por është i vetmi universitet në Shqipëri i tipit tematik. Pra, krahasuar me universitetet e tjera që kanë shumë fusha, Universiteti Bujqësor ka qëndruar në fushën e tij, nuk është shpërqendruar në diploma të ndryshme, ka marrë riskun e reduktimit të numrit të studentëve e të tjera me radhë.

Unë shpresoj që edhe ky komision i nderuar, edhe Ministria e Financave që ta shikojnë në këtë aspekt: çdo ndihmë që i jepet Universitetit Bujqësor, duhet të dini se kthehet mbrapsht 3, 4 apo 5-fish. Ju si anëtarë të këtij komisioni e dini që Shqipëria ka dy prioritete kryesore, bujqësinë dhe turizmin, të cilat janë të lidhura me njëra-tjetrën. Që do të thotë se nuk mund të pretendojmë të mbështesim sektorin e bujqësisë, nëse nuk mbështesim sektorin e edukimit në Universitetin e Bujqësisë, i cili është i vetmi që lëshon këto diploma, nuk ka universitet tjetër.

Përveç kësaj ne jemi të “persekutuar”, por kemi përsëri specifika, që ju të gjithë i konfirmoni. Nëse ka ndonjë deputet që nuk ka ardhur, e ftoj të vijë. Është i vetmi universitet që ka kampus, i cili ka specifikat e veta. Pavarësisht se është i bukur, ju duhet të dini se të gjitha nevojat për energjinë, për pastrim, për ujera të zeza, pra çdo gjë mbulohet nga buxheti i universitetit, që vijnë nga të ardhurat që ne grumbullojmë.

Një specifikë tjetër. Ju duhet të dini se ky kampus nuk i përket më universitetit, por të gjithë lagjes. Pra, aty ka pjesë edhe Bashkia e Tiranës, sepse banorët e kësaj bashkie vijnë të kalojnë çaste, siç shkojnë te Liqeni Artificial. Nëse në universitetet e profesor Benit, e profesor Tanit apo profesor Maliqarit, trotualet, plehrat, ujërat e zeza e të tjera ua heq Bashkia e Tiranës, ne jemi të detyruar t’i heqim me buxhetin tonë. Ndaj, në këtë aspekt, përsëri dua mirëkuptimin tuaj në këta zëra buxheti.

Ky universitet, që përsëri është nder dhe krenari për vendin, ju e dini shumë mirë, zonja Ministre, se e keni vizituar, është i vetmi që ka bankë gjenetike, i cili është institucioni më i rëndësishëm në Shqipëri. Ai mban mbi 5 mijë aksesione farash, fidanësh e të tjera me radhë. Ato shkojnë të dyja paralel, pra nga njëra anë qeveria mbështet agroturizmin, 100 fshatrat turistike e të

tjera me radhë, por ne nuk mund të pretendojmë të mbështesim agroturizmin, nëse nuk kemi resurset tona lokale gjenetike. Kjo bankë gjenetike nuk prodhon diploma, pra nuk ka studentë, por është një aset, që nuk është imi, as i Universitetit Bujqësor, por është i Shqipërisë, çka do të thotë se edhe në këtë aspekt unë do të doja shumë mirëkuptimin tuaj për ta parë buxhetin që të akomodohen edhe interesat e kësaj banke, jo vetëm për rrogat e stafit, por se ata kanë nevojë edhe për shërbime pasi banka duhet të pasurohet të mirëmbahet e të tjera me radhë.

E njëjta gjë, përveç bankës, është edhe për Institutin e Peshkimit. Edhe Instituti i Peshkimit është një institucion që i përket Universitetit Bujqësor, i cili nuk është vetëm për interesin e Universitetit Bujqësor, por është për interesin e gjithë sektorit të peshkimit dhe të bujqësisë në Shqipëri. Pra, kjo do të thotë se janë dy institucione, të cilat nuk gjenerojnë para nëpërmjet, le të themi diplomave apo të ardhurave nga studentët, por gjenerojnë të ardhura indirekte për të mirën e ekonomisë shqiptare.

Ajo që ne kemi si specifike për këtë vit është fakti, kjo falë kontributit tuaj, që ne kemi ndërtuar pas tërmetit dy godina (përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit e dinë, zonja Tola e di, Mirela e di, sepse kemi gjetur mirëkuptimin e tyre), por i kemi të pamobiluara, çka do të thotë që edhe këtu kemi nevojë, sepse nuk kemi kapacitet dhe fuqi. Bëhet fjalë për tri godina të ndërtuara rishtas, të cilat janë bosh, gjynah që rrinë bosh, siç janë Klinika Veterinare, ju vetë personalisht, kur keni qenë ministre, e keni mbështetur dhe godina ka dalë super, godina e Fakultetit të Bioteknologjisë Ushqimore, e cila është komplet bosh, një godinë që u shemb nga tërmeti dhe godina e Departamenti të Mjedisit. Pra, janë tri godina ku rreth 2 mijë studentë faktikisht kanë rreth 3-4 vjet që bëjnë mësim në godina të tjera. E gjithë vlera e mobilimit shkon diku te 1,2 apo 1,3 milionë euro. Ne do të ndiheshim më mirë nëse ju do të mendonit ta përfshinit në buxhetin e këtij viti.

Përveç kësaj, ju e dini shumë mirë, që ne kemi filluar edhe programet duale. Aktualisht, në universitet kam një grup italianësh që po ndjekin programet, së bashku me studentët shqiptarë, dhe të gjitha këto kanë nevojë për përmirësim infrastrukture e të tjera. Ajo që ngelet e pazgjidhur (prapë jam i sigurt se edhe këtë vit nuk do të zgjidhet, shpresoj që këtu të pranishëm të jenë persona nga Ministria e Financave, pasi Ministria e Arsimit nuk ka fuqi) është ajo që lidhet me çështjen e prokurimeve. Unë nuk e kam problem nëse çështjet transferohen nga një vit në vitin tjetër, por bëhet fjalë për një koncept ku ne dallojmë esencialisht me universitetet e tjera jashtë.

Profesoreshë Kushi, besoj se ju e konfirmoni, kur unë kam marrë detyrën në magazinën e Universitetit Bujqësor, kam gjetur mbi 30 lloje markash të ndryshme kompjuterësh, 30 marka të ndryshme printerësh, 30 marka të ndryshme fotokopjesh e kështu me radhë. Imagjinoni se si mund të mirëmbahen këto e gjërat e tjera me radhë. E gjithë kjo vjen nga procedurat e prokurimit faktikisht. Në çdo vend të botës universitetet, nuk e di për institucionet, mund të kenë kontrata me firma që futen short-list, nuk e di se nga cili autoritet, dhe ato më pas mund ta kenë të unifikuar të gjithë këtë proces. Kjo është diçka që mund të zgjidhet fare thjesht, por kuptohet se duhet ndërhyrë te ligji i prokurimeve.

Një gjë tjetër që e kemi me shumë vështirësi, shpresojmë prapë që përfaqësuesit e Ministrisë së Financave të jetë prezentë, është ajo që ka të bëjë me hapjen e numrit të llogarisë për projektet që ne fitojmë. Minimalisht duhen 2 ose 3 muaj për të marrë një numër llogarie dhe për të akomoduar transhin e parë të një projekti e të tjera. Jo më larg unë kisha një projekt në horizont, i cili do të më sillte para financimi, në rregull këto janë banka që i ka vendosur banka qendrore unë nuk futem fare te këto rregulla, por nuk e di se si mund ta zgjidhim këtë, por të presësh edhe 2 apo 3 muaj për një numër llogarie, megjithatë mendoj se kjo do të harxhonte shumë kohë dhe energji. Këto janë thjesht çështje teknike që mund të kenë zgjidhje të shpejtë.

Në përfundim, të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë, duhet të dini faktin se Universiteti Bujqësor që unë përfaqësoj kuptohet që është njësoj, siç është edhe universiteti ku është profesor Tani, pra bëhet fjalë për një universitet që jep diplomë për mjekësi veterinare, që do të thotë se ka nevojë për laboratorë, kafshë, fermë; dega e Bioteknologjia Bujqësore ka nevojë për laboratorë, linjë përpunimi të qumështit, djathit e me radhë; dega e Agronomisë, edhe kjo degë ka nevojë për laboratorë, kimikate dhe autobusë, dega e Inxhinierisë së Pyjeve ka nevojë për laboratorë e të tjera. Pra, të gjitha këto çojnë në rritjen e kostot.

Unë jam i sigurt se të gjithë ju do ta mbështesni propozimin tonë që të kemi një përkujdesje në rritjen e buxhetit. Ju e dini shumë mirë që ne kemi ardhur për të kërkuar, ndërsa ju jeni këtu për të na dëgjuar dhe më pas për të na sugjeruar. Ne nuk kemi ardhur t'ju themi: faleminderit që nuk na keni dhënë!

Fillimisht, ju thamë faleminderit që nuk na keni dhënë, do t'ju themi 10 herë faleminderit po të na jepni pak më shumë!

Unë ju siguroj vetëm për një gjë, këto janë fakte të shkruara, zonja dhe zotërinj deputetë, në buxhetin e Universitetit Bujqësor, se unë nuk ju përmenda reformën që ka ndërmarrë

Universiteti Bujqësor, këtë vit në janar ne do të fillojmë reformën më të thellë të universiteteve shqiptare. Kjo është një reformë, e cila ka nevojë për përpjekje, energji dhe shumë elemente të tjera, por nëpërmjet marrëveshjes, që shpresojmë shumë të kalojë sa më shpejt në qeveri apo në Parlament, në harkun kohor të 4-5 vjetëve Universiteti Bujqësor do të shndërrohet në një tip kantieri. Ne shpresojmë shumë që në harkun kohor të 4-5 vjetëve të ndryshojë e gjithë arkitektura e ofertës akademike, shkencore dhe e transferimit të teknologjive.

Ajo që nisa t'ju them është fakti se, këto janë shifra, nga i gjithë buxheti. Rreth 80-85% e buxhetit të Universitetit Bujqësor sigurohet nga ana e qeverisë dhe 15 deri në 20% janë nga të ardhurat që vijnë nga studentët dhe nga aktivitete të tjera që ne kemi. Fokusi ynë kryesor çdo ditë është që ta ulim në maksimum kontributin që vjen nga qeveria dhe të rrisim në maksimum të ardhurat nga institucioni. Pra, edhe kjo pjesa që është 15-20%, rreth 80% vijnë nga të ardhurat nga tarifat e studentëve dhe vetëm 20% vijnë nga shërbimet. Krahasuar me 3 vjet më parë, sigurisht ka një rritje, unë e kam gjetur 10% dhe e kam çuar aktualisht te 18%, por prapë nuk është e mjaftueshme, sepse ne vërtet duhet t'i shfrytëzojmë hapësirat sa u takon sigurimit të të ardhurave, por këto janë punë që ne i bëjmë vetë me stafin tonë.

Në përfundim të fjalës sime, kërkoj mirëkuptimin tuaj që këto mesazhe të shkojnë të qarta, sidomos te komisioni që jep paratë. Unë e di shumë mirë që ju jeni me ne, na keni mbështetur dhe na mbështesni, por do të doja shumë që Komisioni për Ekonominë dhe Financat, që ka çekun, të jetë sa më mirëkuptues dhe bujar siç ka qenë gjithmonë.

Më lejoni t'ju falënderoj!

Ju uroj punë të mbarë dhe të na vejë puna mbarë edhe për vitin në vazhdim!

Evis Kushi – Faleminderit, profesor, për të gjitha kërkesat, shqetësimet dhe komentet!

Fjalën po ia kaloj menjëherë përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për t'iu përgjigjur shqetësimeve të profesor Artan Hoxhës, rektorit të Universitetit të Tiranës, të rektorit të Universitetit të Mjekësisë, profesor Gjatës, si dhe të rektorit të Universitetit Bujqësor të Tiranës, profesor Sallakut.

Fjalën e ka zëvendësministrja, zonja Tole.

Më pas, fjalën e ka zonja Bimo, nëse ka ndonjë gjë për të shtuar.

Albana Tole – Zonja Kushi, faleminderit për fjalën!

Në radhë të parë, më lejoni të falënderoj të gjithë rektorët për ndërhyrjet e tyre dhe për çështjet e ngritura, të cilat janë shumë të rëndësishme në fushën e arsimit të lartë!

Unë do të doja ta nisja fjalën time, duke specifikuar atë informacion, i cili përfshihet, sigurisht edhe në relacionet mbi projektligjin, duke ju thënë se buxheti për vitin 2024 për Ministrinë e Arsimit dhe Sportin është parashikuar në masën 52 miliardë e 223 milionë lekë dhe parashikohet një shtesë fondi prej 5 miliardë e 49 milionë lekë ndaj buxhetit fillestar të vitit 2023, ose kemi pasur një rritje në masën 10,7% të buxhetit.

Në të vërtetë, nëse do të bëjmë një krahasim me vitet e mëparshme, ky është buxheti më i lartë historik për arsimin, i cili mbështet të gjitha politikat, duke iu referuar këtu rritjes së pagave për mësuesit, rritjes së investimeve në infrastrukturën arsimore dhe atë digjitale në shkolla, si dhe zgjeron financimin për të gjitha programet e arsimit të lartë, programet e ndërkombëtarizimit dhe të kërkimit shkencor dhe në njëjtën kohë garanton mbështetjen e studentëve.

Sigurisht, buxheti për arsimin mbështet investimet kapitale me fondin prej 5 miliardë e 704 milionë lekë, pra rreth 25% më shumë se buxheti fillestar i vitit 2023, ku do të vazhdojë mbështetja për investimet në infrastrukturën e arsimit bazë, të arsimit të mesëm dhe të lartë, si dhe mbështetja për infrastrukturën e kërkimit shkencor.

Sigurisht që ky buxhet i dedikohet arsimit bazë, arsimit të mesëm të përgjithshëm, arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, por ne fokusohemi te dy zërat e fundit, që i referohen pikërisht arsimit të lartë, po ashtu edhe kërkimit shkencor. Për financimin e veprimtarisë së institucioneve publike të arsimit të lartë për vitin 2024 janë planifikuar fonde grant me burim financimi buxhetin e shtetit në shumën prej 13 miliardë e 30 milionë lekë, me një shtesë nominale, e cila arrin në 1 miliard e 450 milionë lekë ose e thënë në nivel përqindjeje, jemi 12,5% më shumë ndaj buxhetit fillestar të vitit 2023.

Struktura e fondeve të programit buxhetor të arsimit të lartë, sipas destinacionit të përdorimit të fondeve për vitin 2024, planifikohet në disa zëra, duke iu referuar këtu shpenzimeve të personelit dhe shpenzimeve të tjera, shpenzimeve të studentëve për akomodimet e tyre, fondit të mbështetjes studentore si pjesë e grantit për mësimdhënien, fondet grant për mbështetjen studentore në kuadër të paktit për universitetin. Në të njëjtën kohë kemi edhe fondet e dedikuara sipas programeve vjetore për mbështetjen financiare me bursa për studentët që ndjekin studimet në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar dhe studentët ekselencë, si dhe mbështetjen për akreditimin institucional të IAL-ve dhe të programeve të studimit.

Fondet për politikat e zhvillimit për institucionet e arsimit të lartë për periudhën 2024-2026 janë parashikuar në masën 1 miliard e 400 milionë lekë. Për vitin 2024, me fondet për mbështetjen

e infrastrukturës për projektet konkurruese të IAL-së do të financohen projekte, sipas ciklit të financimit, duke iu referuar këtu projektit të rindërtimit të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, hartimit të projektit të Kampusit të Universitetit të Tiranës, projektit për rikonstruksionin e ndërtesës së Fakultetit të Gjeologji-Minierave, po ashtu edhe rindërtimin e godinës së Klinikës Veterinare dhe të Laboratorit të Anatomisë së Kafshëve të Universitetit Bujqësor, i parashikuar për vitin 2023-2024, projekti për ndërtimin e godinës së Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike dhe ndërtimi i godinës së Fakultetit të Studimeve Profesionale të Universitetit të Durrësit i parashikuar për periudhën 2023-2025.

Në lidhje me kërkimin shkencor për vitin 2024 janë planifikuar 1 miliard e 582 milionë lekë. Fondet e parashikuara për vitin 2024 janë rritur, dhe këtë dua ta theksoj, në masën 53,8% ose 555 milionë lekë, po ta krahasojmë këtë me buxhetin fillestar të vitit 2023, dhe struktura e fondeve për grantin buxhetor, sipas destinacionit të përdorimit të fondeve për vitin 2024, është e ndarë në disa nën-pika, duke iu referuar këtu nxitjes së punës kërkimore në IAL; projekteve të bashkëpunimit të universiteteve me biznesin privat në programet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit dhe të zhvillimit; pjesëmarrjes në programin “Rising Europe”, që në vetvete synon të rrisë nivelin e performancës së vendit, duke iu referuar këtu një përqindjeje suksesi që varion nga 14 deri në 20% ndaj pjesëmarrësve në programin kuadër. Pastaj kemi fonde financiare për mbulimin e bursave financiare për studentët ekselentë, si dhe fondin për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e shkëmbimit akademik, duke iu referuar 2 programeve “Fulbright”; fondet për pjesëmarrjen në marrëveshjen kuadër në programet e BE-së për kërkimin dhe inovacionin; fondet grant për pjesëmarrjen me të drejta të plota të Republikës së Shqipërisë në programin Erasmus+, program i Bashkimit Europian për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin; si dhe fondet me financim të huaj për vitin 2024 janë parashikuar 500 milionë lekë për financimin apo për bashkëfinancimin e projekteve. Këtu vlen të theksohet se është vënë në dispozicion një fond prej 1,3 deri në 1,4 miliardësh, referuar shtesës së pagave për stafin administrativ, i cili ka qenë një shqetësim i ngritur edhe nga institucionet e arsimit të lartë jo në Tiranë, por në rrethe.

Në tërësi kjo është një përmbledhje. Gjithsesi, për çështjet më teknike dhe më të detajuara unë do t’ia jap fjalën shëfes së Drejtorisë së Financës, zonjës Mirela Bimo.

Faleminderit!

Evis Kushi – Fjala është për ju, zonja Bimo.

Mirela Bimo – Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Faleminderit, të nderuar rektorë!

Zonja Kryetare dhe deputetë,

Atëherë, shumë shkurt unë do të përpiqem të jap disa sqarime për pyetjet e ngritura nga profesorët e nderuar.

Po e filloj me pyetjet e profesor Artanit, sa i përket çështjes së transparencës së kërkesave të të gjitha universiteteve. Në fakt, procesi i hartimit të buxhetit afatmesëm është një proces që merr një cikël gati 8-mujor, duke filluar nga muaji shkurt, kur hartohen tavanet përgatitore të buxhetit afatmesëm, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe ju e dini të gjithë që vendimet e Këshillit të Ministrave janë transparente, publikohen në Fletoren Zyrtare, por njëkohësisht u vihen në dispozicion të gjitha institucioneve, përfshirë edhe institucionet e arsimit të lartë. Megjithatë, për t'i rënë shkurt, ne po e mbajmë shënim kërkesën e rektorit, me qëllim që ta kemi parasysh kur të përfundojë cikli i hartimit të buxhetit, që është *dateline*-i zyrtar i Ministrisë së Arsimit për ta paraqitur buxhetin në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, që është data 31 gusht. Pas kësaj date ne e kemi çuar të gjithë buxhetin e hartuar, sigurisht referuar tavaneve buxhetore që miratohen me vendimin e Këshillit të Ministrave, por referuar edhe kërkesave shtesë të cilat ne i paraqesim në Ministrinë e Financave, pikërisht në përgjigje të kërkesave shtesë që mund të kenë institucionet e tjera, përfshirë edhe institucionet e arsimit të lartë. Duke qenë se kjo është një kërkesë të cilën unë e dëgjoj për herë të parë dhe kërkoj ndjesë, ose nuk kemi qenë të vëmendshëm, ose nuk është elaboruar nga ana juaj, por patjetër ne mund ta vëmë në dispozicion të universiteteve. Kjo ishte për sa i përket transparencës.

Lidhur me pyetjen e të dy profesorëve, edhe të profesor Gjatës, edhe të profesor Tanit, për sa i përket buxhetit paraprak të çdo institucioni përpara muajit janar, unë dua të nënvizoj që detajimi i buxhetit sipas çdo institucioni të arsimit të lartë, në fakt, është një proces i cili bazohet në disa kritere dhe në një formulë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Parimi i kësaj formule, pra i shpërndarjes së grantit në universitete, është parimi për student. Kjo do të thotë që, pa u miratuar me ligj buxheti, për ne është e pamundur ta bëjmë këtë shpërndarje apo këtë informim zyrtar te IAL-të, për sa kohë procesi nuk është i rregullt dhe ligjor, duke pasur parasysh edhe miratimin e fondit total për Ministrinë, por edhe për çdo universitet, kur momentalisht jemi në mesin e muajit tetor dhe ende nuk është bërë miratimi i buxhetit. Këtu formula, së cilës unë iu referova, që përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, merr në konsideratë numrin e studentëve, që, siç e dini, saktësohet pas regjistrimit në universitete dhe pas marrjes së konfirmimit

të numrit nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, pra nga QSHA-ja. Pra, ky është një proces që ka teknikën e tij, por ka edhe përcaktime ligjore dhe ne e kemi të pamundur t'i kemi qysh në muajin tetor apo në fillim të muajit nëntor. Gjithsesi, ka qenë praktikë që në datën 1 janar të çdo viti të gjitha universitetet i kanë pasur fondet, të paktën grantin e mësimdhënies ose ato që quhen shpenzime operative. Në datën 1 janar universitetet i kanë në llogarinë e thesarit dhe pastaj ndiqen procedurat e tjera me vendim të Bordit të Administrimit, ku bëhet edhe detajimi dhe shpërndahen fondet për shpenzime operative, për pagat, për sigurimet shoqërore e kështu me radhë.

Ndërsa sa u takon fondeve për investimet, edhe këtu është një procedurë standarde, të cilën ne e ndjekim në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. Nga praktika rezulton që këto hapen rreth 1 muaj me vonesë, pasi bëhen rakordimet edhe me Thesarin, për projekte të cilat kanë qenë në vazhdim dhe vijojnë të likuidohen edhe gjatë muajit janar. Pra janë disa procedura specifike për të cilat, me të gjithë sensin për t'i përshpejtuar, edhe ne e kemi të pamundur, sepse duhet të bëhen rakordimet përkatëse.

Lidhur me çështjen që me të drejtë e ngriti profesori, ka një shtesë të fondet e arsimit të lartë e cila në total shkon në 1,9 miliardë. Edhe për këtë, nëse do të ketë një rakordim me strukturat teknike, pasi profesorët e nderuar janë pjesë e stafit akademik dhe ndoshta nuk janë edhe aq shumë të përfshirë në çështjet e buxhetit dhe normalisht nuk ka pse të jenë, në një tabelë specifike, që është aneksi i pestë i ligjit të buxhetit, nëse do të shihet me kujdes nga teknikët, aty kuptohet se rritja është gati 1,4 miliardë të fondet grant që shkuan tek institucionet dhe diferenca 500 milionë shkon tek investimet e infrastrukturës, te projektet e ndërkombëtarizimit apo të kërkimit shkencor.

Sa i përket kërkesës së profesor Gjatës për investimet në infrastrukturë, unë doja të nënvizoja se universitetet, përveç fondeve që marrin nga buxheti i shtetit, pa dyshim kanë edhe kontributin nga të ardhurat të cilat ata i sigurojnë vetë dhe jo çdo kërkesë e tyre plotësohet nga buxheti i shtetit. E mira do të ishte të plotësohej, por për vitin 2024 për universitetet janë parashikuar të mblidhen rreth 3 miliardë e 120 milionë lekë të ardhura nga tarifat e studentëve, por edhe nga vetë shërbimet e universiteteve apo nga tarifat që arkëtojnë e sigurojnë të ardhura. Në raport me fondet që marrin nga buxheti, këto përfaqësojnë gati 24%. Pra, 24% e buxhetit total, unë flas në kuadër makro për të gjitha IAL-të publike, janë të ardhurat që sigurojnë universitetet dhe e gjithë diferenca 86% sigurohet nga buxheti i shtetit, që vetëm për vitin 2024 llogaritet në shifrën gati 130 milionë euro vetëm për programin e arsimit të lartë, pa përfshirë këtu kërkimin shkencor.

Thënë këtë, për Universitetin e Mjekësisë, për shembull, i cili ka pasur probleme me godinën, unë dua të nënvizoj që kanë fonde të trashëguara vit pas viti, sidomos universitetet e mëdha, siç është ai i Mjekësisë, i Tiranës, dhe që nuk i kanë realizuar procedurat sa u përket edhe investimeve. Profesori me të drejtë tha që këto fonde janë të alokuara te Fakulteti i Mjekësisë së Përgjithshme, nuk e di nëse jam e saktë, dhe nuk mund të përdoren për fakultetin tjetër. Në fakt, praktika është që ato janë fonde të Universitetit dhe prandaj janë organet kolegjiale në universitete. Ato marrin vendimin që këto fonde të shpërndahen apo të rishpërndahen nga një fakultet në një tjetër. Pra nuk është taksative që, meqë këto fonde janë të alokuara në një fakultet, ato duhet të rrinë të ngrira aty dhe të mos përdoren për nevojat e universitetit. Ky është një sugjerim që ju ndoshta mund ta diskutoni edhe me strukturat e brendshme për t'i dhënë zgjidhje.

Sa i përket qendrës së biostimulimit, është e vërtetë, sikurse ju e përmendët, që ka pasur një ndërhyrje edhe nga Agjencia, dhe ne jemi në fazën kur duhet të kërkojmë informacion edhe nga ata, sepse nuk mund të planifikojmë edhe ne fonde paralelisht me Agjencinë tjetër, ku mund të kërkohen financime nga donatorët.

Sa i përket kampusit të Universitetit të Tiranës, me të drejtë profesor Hoxha e ngriti këtë çështje. Unë dua të nënvizoj që Ministria e Arsimit dhe Sportit prej gati 2 vjetësh i ka akorduar Bashkisë së Tiranës fondin prej 500 milionë lekësh për projektimin, pasi përpara fillimit të punimeve, në fakt, realizohet procesi i hartimit të projekteve teknike për të gjitha godinat që janë parashikuar të jenë pjesë e kampusit të Tiranës. Sipas informacionit që kemi dhe komunikimeve të shpeshta me Bashkinë e Tiranës, ajo e ka finalizuar procesin e projektimit, ka nënshkruar kontratën dhe tanë është në fazën e likuidimit të kontratës së projekteve dhe menjëherë pas përfundimit apo marrjes në dorëzim të këtyre projekteve fillon faza e dytë, që është ajo e zbatimit. Duke qenë se bëhet fjalë për një investim me vlerë të konsiderueshme, është e pamundur të përballohet vetëm nga buxheti i një viti të Ministrisë së Arsimit. Edhe këtu do të shihen modalitetet për ta bashkëfinancuar ose për të kërkuar donatorë, edhe për ta shtuar gjatë vitit nëpërmjet akteve normative apo rialokimeve të buxhetit, për fillimin e punimeve për kampusin. Megjithatë, Ministria e Arsimit qysh vitin e kaluar ka filluar investime pjesore për Universitetin e Tiranës. Pra, për Fakultetin e Drejtësisë qysh këtë vit kemi parashikuar një fond rreth 80 milionë lekë të rinj, bazuar në projektin që universiteti ka paraqitur. Në dijeninë tonë, sipas informacionit që kemi, Universiteti i Tiranës ka nënshkruar kontratën dhe është në fazën e fillimit të punimeve të kësaj kontrate, e cila do të jetë pjesë e kampusit të Tiranës.

Gjithashtu, ju e përmendët edhe vetë, vetëm në vitin 2023 nga projektet e ndërkombëtarizimit Universiteti i Tiranës, por edhe ai i Mjekësisë, kanë përfituar respektivisht 4 projekte ndërkombëtarizimi ka fituar Tirana, 3 projekte Universiteti i Mjekësisë. Universiteti Bujqësor nuk ka aplikuar për projekte të mirëfillta ndërkombëtarizimi, por, sikurse e përmendi rektori, ka kërkuar pajisje për godinat që kanë përfunduar, gjë që do ta vlerësojmë për vitin 2024.

Sa u përket çështjeve që lidhen me datën 15 tetor për procedurat e prokurimit, patjetër edhe ne, si ministri, e kemi pasur shqetësim dhe e kemi kërkuar në mënyrë të përsëritur edhe pranë komisioneve tuaja, por edhe pranë Ministrisë së Financave. Në fakt, duke qenë se universitetet, sikurse e përmendëm, gati 80% të fondeve i kanë fonde buxhetore dhe për sa kohë këto janë të tilla, duhet t'u nënshtrohen të gjithë rregullave të procesit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit. Nuk dëshirojmë që të ketë devijime të tilla nga rregullat e menaxhimit, megjithatë jemi të hapur dhe do t'i vazhdojmë komunikimet me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë për të gjetur një zgjidhje optimale.

Faleminderit!

Evis Kushi - Zonja Bimo, shumë faleminderit, për të gjitha përgjigjet e detajuara!

Nuk e di nëse rektorët e morën përgjigjen që prisnin.

Fjala për profesorin.

Artan Hoxha – Shumë faleminderit, zonja Kushi!

Unë isha shumë i qetë, i butë, dashamirës.

Lidhur me transparencën, ajo është kërkuar për herë të parë nga ne. Në qoftë se Kuvendi hap protokollin e tij, aty janë shkruar pothuajse të njëjtat gjëra. Këtë vit preferova të mos i sillja të shkruara, sepse i sollëm vitin e shkruar dhe mbetëm përsëri këtu ku jemi sot.

Ky është një proces që bëhet bashkë me institucionet e arsimit të lartë, nuk është as i këtij viti, as i vitit të kaluar dhe as i parvjetshëm. Ky është një proces që nuk po zhvillohet normalisht me institucionet e arsimit të lartë. Kjo do të thotë që ne nuk jemi përfshirë, ndërkohë vijmë dhe diskutojmë elementin fundor, projektbuxhetin, që qeveria ia propozon Kuvendit të Shqipërisë pa asnjë informacion shtesë. E para.

E dyta, nuk ka informacion, unë e kam parë relacionin e ministrisë, kam parë edhe relacionin e Këshillit të Ministrave, të dy relacionet janë skematike, janë me pika, unë e kam para madje

Është shumë e drejtë ajo që thuhet se disa nga gjërat që thamë nuk janë çështje të këtij buxheti, por janë çështje të ndarjes së buxhetit me vendim të Këshillit të Ministrave, pra të detajimit të tij sipas institucioneve, me formulën që tha drejtoresha. Por, kur shkohet te ndarja, te formula, tek akumulimi e të tjerë, duhet të bashkohen të gjitha kërkesat e institucioneve të arsimit të lartë dhe më pas t'i propozohen Ministrisë, sipas nevojave që ka gjithsecili. Ne e dimë që buxheti diskutohet, asnjëherë nuk jepet ai buxhet që kërkohet, por ama dimë se cilët janë ata komponentë që përbëjnë atë shumë fundore që, me të drejtë, u tha se është 90 milionë euro e diçka mbi buxhetin e shkuar.

Ne rektorët dimë shumë për buxhetin. Edhe pse zonja drejtoreshë tha që s'kemi pse të dimë, ne duhet të dimë madje më shumë për buxhetin, pavarësisht se nuk kemi kompetenca administrimi. Buxhetet, këtë duhet ta dini, krijohen nga strukturat akademike, pastaj miratohen në bord. Pra bordi, administratorët, nuk zhvillojnë buxhete në mënyrë individuale, jashtë nevojave të ushtrimit të misionit të arsimit të lartë. Ne nuk kemi misionin që kanë institucionet e tjera, por kemi misionin që na ka ngarkuar ligji. Buxheti formohet sipas nevojave akademike dhe kërkimit që ne kemi. Kështu që ne patjetër që marrim pjesë dhe e dimë se si zhvillohet buxheti. E dimë shumë mirë që ai 1,9 është i ndarë në dy zëra, sepse e thotë vetë projektbuxheti: 13 milionë janë për universitetin dhe 1 miliard janë për shkencën, ku futen brenda të gjitha elementet që diskutuam.

Ajo që duhet thënë është se nuk analizohet e vjetshmja, në kuptimin që ky investim është për Universitetin e Tiranës, ai ishte buxheti i vjetshëm. Ne sot nuk po bëjmë ndonjë analizë të realizimit të buxhetit të vjetshëm, se po ta bënim unë do t'ju thosha se Universiteti i Tiranës nga buxheti i shtetit ka marrë 80% të pagave dhe sigurimeve shoqërore për personelin e vet. Ky është buxheti që kemi marrë ne, dhe të gjitha fjalët e tjera përdoren për makijazh, ndërsa pa makijazh aq është fondi që na vjen në substancë.

Çfarë fitojmë me projektet dhe konkurrimet, ato janë gjë tjetër dhe nuk vijnë drejtpërdrejt për universitetin, por vijnë si rezultat i projekteve.

Nëse flasim për projektin e Fakultetit të Drejtësisë, që tani ka filluar implementimin, nuk ka lidhje fare me buxhetin që ne projektojmë për vitin 2024. Për vitin 2024 unë kisha një pyetje: a është planifikuar në buxhetin e shtetit ajo që thuhet në një pjesë të relacionit, që janë disa kampuse, ku përfshihet edhe Kampusi i Universitetit të Tiranës? Nuk e ndava Kampusin e Universitetit të Tiranës nga kampuset e tjera, sepse e di, pa ma thënë njeri paraprakisht, që buxheti është total, pastaj ndahet. Gjithashtu di që në bashki ka dy vjet që projektohen të gjitha këto kampuse, pra si

do të duken dhe efektet e ekzekutimit të tyre. Di që janë në përfundim, se jemi në komunikim të vazhdueshëm.

Pyetja që kam është: a ka buxhet të planifikuar në buxhetin e vitit 2024 për kampuset në tërësi, pastaj do t'i ndajë qeveria, kur të vijë buxheti i miratuar nga Kuvendi? Këtë përgjigje jam i interesuar ta di, pra ku jemi në këtë buxhet. E bëj këtë pyetje për efekt të investimit, jo sa pagë marrim dhe sa është rritja e pagës, sepse ato janë të gjitha të ditura dhe janë të mbuluara 80%, jo 100%, sepse kaq është buxheti. Pra, për efekt të investimeve unë dua të di: a janë parashikuar këto kampuse në zërin buxhetor, ngaqë ne nuk e kemi këtë informacion?

Po të më thoni për fondin 1,5 miliardë, që është i akorduar për shkencën, po jua jap unë përgjigjen: nuk ka parashikim buxhetor. Nuk e di, se ndoshta buxheti i shtetit mund të ketë një zë tjetër, mund t'i çojë në bashki, mund t'i çojë në një zë që unë nuk kam ku ta shoh. Këtu po flasim për arsimin e lartë, nuk po flasim për arsimin në tërësi. Dy zëra ka arsimit të lartë: arsimit dhe fondet për shkencën. Kështu që pyetja ime është: për këtë që thuhet në relacion për kampuset, a ka parashikim buxhetor, apo jo?

Evis Kushi - Faleminderit, profesor!

Zonja Bimo, fjala për ju.

Mirela Bimo – Lidhur me pyetjen e profesorit, është e vërtetë që bashkë me tabelat e ligjit, të cilat janë në makro, fondet për programet e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor, pra bashkë me tabelat shoqëruese të buxhetit është edhe lista e investimeve, ku janë të parashikuara të gjitha projektet në vazhdim për institucionet e arsimit të lartë për periudhën afatmesme 2024-2026. Nuk e di nëse kanë pasur mundësi ta shohin listën analitike të investimeve, por aty janë të detajuara të gjitha projektet, të cilat janë në vazhdim.

Unë e përmenda projektin e Universitetit të Tiranës, i cili ka filluar këtë vit, por është e pamundur që ky investim të përfundojë këtë vit, kështu që ai detyrimisht duhet të vijojë të financohet edhe për vitin 2024. Ky projekt është i përfshirë te lista analitike e investimeve, sikurse në periudhat në vijim është i përfshirë edhe financimi për Kampusin e Universitetit të Tiranës.

Më lejoni të nënvizoj një specifikë, që pa përfunduar procesi i projektimit dhe i marrjes në dorëzim të projekteve, ne, nga ana ligjore, e kemi të pamundur të vendosim një vlerë të saktë investimi, sepse duhet që procedurat ligjore ta lejojnë këtë, por në buxhetin afatmesëm 2024-2026 sigurisht që është parashikuar edhe financimi përkatës.

Faleminderit!

Evis Kushi - Profesor, besoj se ishte e qartë përgjigjja.

Edhe një herë fjala për profesor Hoxhën.

Artan Hoxha – Për mua nuk ishte e qartë përgjigjja. Punimet në Fakultetin e Drejtësisë nuk kanë të bëjnë me kampuset, por kanë të bëjnë me rehabilitimin e strukturave që ka Universiteti i Tiranës. Në këtë pikë nëse është një universitet që nuk ka marrë financim, është universiteti më i madh i vendit. Pyetja ime ishte shumë konkrete, më mirë thoni se nuk e keni, dhe na lini të bisedojmë në nivele të tjera.

Ajo çfarë po them është kjo: nuk jemi në PBA, nuk jemi as në buxhetin afatmesëm 2024-2026, por jemi në projektbuxhetin e vitit 2024. Në vitin 2023 përfundoi studimi dhe përfundon edhe projektimi i kampusit. Kampus do të thotë ndërtimi i ri për Universitetin e Tiranës, brenda kësaj janë edhe disa rehabilitime. Pyetja që kam është: a ka buxhet të parashikuar për Universitetin e Tiranës, por janë edhe kampuset e tjera? Lëreni si ndahet buxheti kur të miratohet.

Kur kërkohen para thuhet se duhen për këtë, duhen për këtë, duhen për atë. A është parashikuar buxhet për këto kampuse, të cilat kanë disa vite që mbeten në tavolinë. Unë pyetjen e kam të drejtpërdrejtë, sepse buxhetin e njoh shumë mirë për shkak të detyrave të mëparshme, por edhe të këtyre që kam sot. Unë dua të di: a është parashikuar buxhet për kampuset dhe sa është vlera, jo për infrastrukturën shkencore? Për këtë pyetje dua një përgjigje. Ne nuk kemi ardhur të bëjmë polemikë me njëri-tjetrin.

Evis Kushi – Nuk e di nëse zonja Bimo ka nevojë ta marrë edhe një herë fjalën, por, zonja Bimo, me sa kuptova, në fund të fjalës së saj theksoi se pa përfunduar plotësisht projektimi nga ana ligjore, e kanë të pamundur të vendosim një zë specifik në buxhet.

Artan Hoxha - Projektimi ka përfunduar. Nëse do të luajmë, që ta mbajmë projektimin deri në ditën e fundit, atëherë më thoni që nuk ka.

Evis Kushi – Faleminderit, zonja Bimo!

Mirela Bimo – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë besoj se ishim të qartë. Është e vërtetë që profesori po pyet për buxhetin e vitit 2024, por kur miratohet në Kuvend buxheti i vitit 2024 ligji ka tri tabela shoqëruese, që i ka për të 3 vjetët: për vitin 2024, për vitin 2025 dhe për vitin 2026. Edhe ajo lista e investimeve, të cilën unë e përmenda pak më parë, e cila i ka të detajuara projektet për secilin nga këto vite...

Artan Hoxha - Ju lutem, më jepni përgjigje! Më thuaj: po ose jo...

Mirela Bimo - Këtë po përpiqem të sqaroj.

Nuk e di sa isha e qartë në sqarim, por unë nënvizova se pa përfunduar plotësisht procesi i projektimit, që është një proces të cilin nuk e realizon ministria jonë, por, me një vendim të Këshillit të Ministrave, i është ngarkuar Bashkisë së Tiranës, për ne është e pamundur të planifikohen fondet për godinat, se nuk e dimë se çfarë duhet të planifikojmë, pra nuk e kemi konkretisht vlerën për kampusin e çdo fakulteti që ta përfshijmë në investim.

Nga ana tjetër, referuar ligjit, ka një parim, pra ne duhet të praktikojmë investimet që janë në vijim. Unë prandaj e përmenda Fakultetin e Drejtësisë, për të thënë se ligjërisht jemi të detyruar që brenda këtij tavani të buxhetit që kemi për vitin 2024, do të përfshijmë financimin në vijim të kësaj godine, e cila ka nisur këtë vit, por edhe të godinave të tjera, të cilat janë miratuar nga ministria dhe, në vazhdim, kur mbeten fonde për projekte të reja, planifikohen fonde për projekte të reja.

Ky është parimi, i cili është i shkruar në ligjin për menaxhimin financiar të kontrollit, por edhe në udhëzimet e ministrit të Financave, për të cilin nuk bëjmë dot përjashtim. Por, nëse do t'i referohemi edhe një herë listës, në vitin 2025- 2026 ajo është planifikuar në formën e një fondi grant për Kampusin e Tiranës. Ndërkohë, ne e kemi të hapur mundësinë që menjëherë, sapo Ministrisë së Arsimit t'i vihet në dispozicion projekti i përfunduar nga Bashkia e Tiranës, të bëjmë rialokimet e nevojshme buxhetore apo t'i kërkojmë Ministrisë së Financave shtesë në buxhetin e vitit 2024, apo të koordinojmë me agjencinë, pra me SASPAC-un, për të kërkuar ndoshta, (kjo kështu është thënë nga donatorët), financimin e këtij projekti, i cili në vlerësimin tonë ose në vlerësimin paraprak të Bashkisë së Tiranës, e cila ka paraqitur një projektide, shkon rreth 180 milionë euro. 180 është e pamundur të parashikohen në buxhetin e Ministrisë së Arsimit vetëm për një vit buxhetor, sepse edhe vetë procesi i ndërtimit të kampusit është një proces që merr kohën e vet, ka kohëzgjatjen e tij dhe nuk mund të planifikohet vetëm për një vit ose tre vjet buxhetor. Nuk e di nëse isha e qartë, por ky është sqarimi që mund të jap unë teknikisht.

Evis Kushi – Faleminderit!

Artan Hoxha - Këtu jemi në Kuvendin e Shqipërisë dhe pushtetet janë të ndara. Edhe kjo loja bashki-ministri, që nuk është as e sivjetshmja, nuk është as vjetshmja, por ka disa vite, që secili e lë tek tjetri, pasojën ua jep universiteteve. Nuk e shikoj as të arsyeshme, as serioz faktin që vijmë në fund të vitit 2023 për të bërë buxhetin e vitit 2024 dhe themi të njëjtat gjëra që kemi thënë 3 vjet rresht.

Unë e kuptoj shumë mirë drejtoreshën, që nuk ka si planifikon kur nuk ka projekte.

Atëherë, kërkesa që kam për Kuvendin e Shqipërisë është: universitetet nuk duhen parë si institucione që u jepen vetëm rrogat dhe sigurimet shoqërore; universitet duhen mbështetur. Ashtu siç u kërkojnë universiteteve të performojnë, t'u përgjigjen sfidave që ka arsimit i lartë në Shqipëri, që t'i mbajmë studentët tanë këtu dhe të edukojnë breza dhe specialistë, që t'i shërbejnë vendit, ashtu duhet edhe përkujdesja, ashtu duhen edhe kushtet për t'i zhvilluar këto veprimtari.

Ne nuk mund të vijmë çdo vit, se bëhemi edhe qesharakë në njëfarë mënyre dhe themi të njëjta gjëra ose disa gjëra pak më ndryshe dhe ajo që na prezantohet ne është që nuk gjen kohë bashkia me ministrinë. Unë dua të them se është shumë e kollajtë të gjesh kohë, nëse do, dhe është shumë e vështirë, nëse nuk do.

Kështu, kërkesa që kam për komisionin tuaj është: vëmendje për arsimin e lartë. Kjo tregohet në buxhet, nuk tregohet as me fjalë, as me deklarime. Por që të vijmë ne sot dhe të flasim ende për mosrakordim mes institucioneve për diçka që është vendosur me kohë, me vendim të Këshillit të Ministrave, përpara kësaj qeverie, kjo nuk më duket serioze për arsimin e lartë.

Nuk mund të themi që u rritën pagat dhe pati disa rezultate; shumë mirë që u bë, ndoshta të vonuara, por kjo nuk ishte vetëm për arsimin e lartë. Ka ardhur koha që këto gjëra të ndryshojnë, dhe shumë mirë që po bëhen. Në lidhje me efektet e vlerësimit, vlerësim më të lartë se ç'kemi bërë, nuk mund të bëjmë më. Këtu nuk kemi ardhur të bëjmë elozhe, kemi ardhur për buxhet. Për shkak të një buxheti, që nuk na paraqitet paraprakisht, ne vijmë dhe flasim në terr, themi se ka një listë; kur pyesim, na thonë se ka një zhvillim nga viti 2024- 2025- 2026. Pyetja është e thjeshtë: a fillojnë në muajin kur fillon viti i ri buxhetor punimet në kampuset që janë parashikuar, apo jo? Unë përgjigjen e mora: jo. Duke qenë e tillë unë, si kryetar i Konferencës së Rektoreve dhe si Rektor i Universitetit të Tiranës, nuk ndihem mirë.

Faleminderit!

Evis Kushi – Profesor, unë edhe një herë dua të shpreh vullnetin e këtij komisioni parlamentar, të gjithë Kuvendit, të qeverisë, por edhe të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për t'i mbështetur universitetet, për ta mbështetur arsimin e lartë.

Unë, me sa kuptova, edhe nga shpjegimet e zonjës Bimo, pavarësisht se nuk ka një zë specifik për Kampusin e Universitetit të Tiranës, ekziston mundësia, patjetër që dashamirësia është e të gjithëve, që menjëherë sapo të kemi projektin nga ana e Bashkisë së Tiranës, të bëhet rialokimi i fondeve dhe mbështetja e këtij institucioni, mbështetja e komisionit, mbështetja e Kuvendit patjetër që do të jetë maksimale, në mënyrë që puna të fillojë menjëherë.

Unë e mirëkuptoj plotësisht shqetësimin tuaj, sepse është një çështje dhe një shqetësim që ju e ngrini tashmë prej vitesh. Patjetër që do t'i shtojmë të gjitha forcat, edhe bashkëpunimin, edhe koordinimin me njëri – tjetrin, në mënyrë që ky problem të zgjidhet.

Nuk e di nëse kanë deputetët ndonjë pyetje, diskutim apo ndonjë çështje për të ngritur?

Fjalën e ka zoti Beqiraj, por do t'ju lutesha sa më shkurt, sepse janë në pritje edhe të ftuarit e tjerë.

Ismet Beqiraj – Të nderuar profesorë, urimi që po ju bëj që në fillim është: qoftë i bardhë buxheti i 2024-2026!

Nuk kam pyetje, por unë u bashkohem shqetësimeve dhe kërkesës së profesorëve. Meqë jemi ende në diskutimin në parim, mund të bëhen korrigjime, parashikime dhe plotësime edhe gjatë kësaj kohe. Sigurisht, i bashkohem shqetësimit të profesor Artanit: Korpusi i Universiteti të Tiranës ka qenë çdo vit buxhetor, pra para kësaj legjislature, por edhe në vazhdimësi, ndaj ose të parashikohet dhe të financohet, ose të hiqet fare. Këtë e mbështes me të dyja duart, se është krenaria e të gjitha universiteteve, pa i ulur vlerat asnjë universiteti tjetër, dhe me të duhet të krenohet e gjithë Shqipëria dhe kombi ynë. Sigurisht, do të bëjmë të mundur, qoftë me iniciativa të komisionit, por edhe të deputetëve, që gjatë vitit ushtrimor 2024 të rialokohen fonde, edhe pse të veçanta, për përfundimin e projektit, sipas rregullave dhe ligjeve, sepse pa projekt, të them të drejtën, nuk planifikon fonde për zbatimin.

Nga ana patjetër, këtë e kam me përfaqësueset e dy ministrive përkatëse, në lidhje me projektbuxhetin kam një shqetësim për personelin e ri akademik, për pedagogët që vazhdojnë punën dhe ata në perspektivë rekrutimi. Me të drejtë e shprehu dhe profesor Tobi, është e vështirë t'i rekrutosh, sepse pagesa e pedagogëve të rinj nuk bëhet sipas vendit të punës, por bëhet sipas vendit të punës, nivelit të gradave shkencore dhe titujve akademikë. Ndaj, unë do të sugjeroja që të rishikohet mundësia për një paketë mbështetëse sociale për pedagogët e rinj, në mënyrë që të mos e kenë mendjen për të ikur, sikurse kanë ikur, por ta pranojnë këtë punë (unë e shikoj me shumë shqetësim këtë). Pra, unë sugjeroj që të ketë politika sociale për strehimin dhe për karrierën e tyre akademike.

Së dyti, lidhur me planifikimin buxhetor të vitit 2024 nuk e di, sepse nuk pashë, dhe me të drejtë bëra një pyetje pak më parë, te dëgjesa para kësaj, lidhur me raportin pedagog i jashtëm-pedagog i brendshëm në mësimdhënie dhe praktika laboratorike dhe praktika në universitete. Dikur në Universitetin e Tiranës kanë qenë gati gjysmë për gjysmë, 45 me 55 në favor të atyre të

brendshmëve, por ka qenë një numër i madh, ndoshta ky numër ka rënë dhe uroj që ky raport të jetë thyer edhe në universitetet të tjera.

Ndaj, sugjeroj që këta pedagogë që vijnë me këtë status, duhet të vlerësohen, pra, jo të shpërdorohet ndjenja e tyre dhe dashuria për mësimdhënien dhe kulturën, sepse vlerësimi i punës dhe orës akademike që bëjmë është simbolike. Ndaj, duhet edhe një zë i posaçëm, i veçantë në projektbuxhetin për institucionet e arsimit të lartë, në mënyrë që edhe cilësia e mësimdhënies të rritet më shumë, por edhe këta të kenë një vlerësim dinjitoz, jo një vlerësim simbolik, në nivelin e një punëtori të pakualifikuar.

Nga ana tjetër, është një debat shumë i madh, sidomos në universitet, lidhur me statusin e personelit ndihmës mësimor. Duhet ndarë ky status. Të nderuar kolegë rektorë, në qoftë se është nevoja të bëhen ndryshime ligjore, jam i pari që e përkrah, sepse punonjësit ndihmës mësimor janë në krah të profesorit, të pedagogut, marrin pjesë në projektet e ndryshme të kërkimit shkencor, janë në udhëheqje të doktoraturave dhe diplomave që bëjnë pedagogët. Nuk duhet të paguhen njëjloj si një specialist i administratës, por duhet të ndryshojë.

Një problem tjetër, që besoj se e kanë të tria universitetet, ndoshta nuk ishte vendi i duhur kur e shtrova në dëgjesën e parë, lidhet me koeficientin e vështirësisë për vende pune të vështira dhe të rrezikshme për jetën e njerëzve. Pra, koeficienti i vështirësisë për pedagogët që japin praktikat laboratorike, sidomos në shkencat ekzakte, në të tria universitetet është hequr me një vendim qeverie para disa vitesh, besoj në vitet 2006-2007. Këtu ka një diskriminim në vlerësimin e saj dhe një shkelje të Kodit të Punës për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit. Këtë vështirësi e marrin ndihmësmësimorët me arsim të mesëm dhe nuk e marrin pedagogët me arsim të lartë.

U lutem, të dyja institucioneve, Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Financave, nuk duhet të luani pingpong me këtë çështje, por duhet ta zgjidhni njëherë e mirë!

Uroj që edhe shqetësimet e tjera që ka profesorati, sidomos përfaqësuesit e tyre, rektorët, të cilët janë njerëz të zgjedhur, siç jemi ne deputetët, duhet të vlerësohen me vepra dhe jo me fjalë të shkruara në letër! Ju faleminderit!

Evis Kushi- Faleminderit shumë, zoti Beqiraj!

Edhe një herë, i falënderoj shumë të tre rektorët që ishin prezentë, për të gjitha shqetësimet dhe për të gjitha sugjerimet!

Shumë faleminderit përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë!

Shumë faleminderit, deputetëve dhe mbarësi për buxhetin e ri!

Edhe një herë shpreh mbështetjen që ky komision dhe Kuvendi i Shqipërisë ka për arsimin e lartë dhe jeni gjithmonë të mirëpritur të na sillni shqetësimet tuaja dhe ne të bëjmë maksimumin për të koordinuar me institucionet e tjera për t'i zgjidhur!

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Këtu mbylлим këtë seancë dëgjimore, të nderuar deputetë.

Për 5 minuta fillojmë mbledhjen tjetër, qëndroni në linjë, ju lutem, mos u largoni!

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2023, ora 15:00 *online*

Drejton mbledhjen:

Evis Kushi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1.Seancë dëgjimore me Akademinë e Shkencave për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

Marrin pjesë:

Evis Kushi, Lindita Buxheli, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Ilir Topi, Ilir Metaj, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Eslemvera Zake, Meri Markici, Ina Zhupa, Kastriot Piroli, Eralda Bano, Merita Baku, Orjela Nebijaj dhe Ismet Beqiraj (zëvendësues).

Mungojnë:

Flutura Aça, Petro Koçi, Andia Ulliri dhe Agron Gjekmarkaj.

Të ftuar:

Ruzhdi Kuçi- kancelar i Akademisë së Shkencave,
Rajmond Perolli- administrator në Akademinë e Studimeve Albanologjike,
Mimoza Monka- shefe Sektori për Buxhetin dhe Financat në Akademinë e Shkencave,
Gentian Opre – drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,
Mimoza Dhëmbi – drejtore e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,
Vilma Çausholli - përgjegjëse e Sektorit të Analizës së Buxhetit Qendror në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,
Albana Tole – zëvendësministre e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit,

Mirela Bimo – drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

HAPET MBLEDHJA

Evis Kushi- Të nderuar kolegë,

Jemi gati për të filluar mbledhjen e radhës.

Siç ju njoftuam edhe pak më parë, kjo mbledhje ka dy pika në rendin e ditës: seancën dëgjimore me Akademinë e Shkencave për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” dhe diskutimi dhe miratimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

Fillimisht verifikojmë kuorumin e mbledhjes.

Të pranishëm janë: zonja Eralda bano, zoti Eduard Ndreca, zonja Teuta Ramaj, zonja Dasantila Tahiraj, zonja Lindita Buxheli, zoti Ilir Topi, zonja Meri Markici, zoti Ismet Beqiraj, zonja Enslemvera Zake, zonja Blerina Gjylameti, zoti Florenc Spaho dhe zoti Kastriot Piroli.

Kuorumi plotësohet, mund të fillojmë menjëherë me pikën e parë të rendit të ditës: seancë dëgjimore me Akademinë e Shkencave për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”. Të ftuar janë: zoti Ruzhdi Kuçi, kancelar i Akademisë së Shkencave, zoti Rajmond Perolli, administrator në Akademinë e Studimeve Albanologjike, dhe zonja Mimoza Monka, shefe Sektori për Buxhetin dhe Financat në Akademinë e Shkencave.

Fjala për përfaqësuesin e Akademisë së Shkencave dhe, më pas, hapim seancën e pyetjeve dhe diskutimeve nga deputetët.

Fjala për ju.

Ruzhdi Kuçi - Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Akademia e Shkencave vjen në dëgjuesën me Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik me objekt: diskutimi në parim i projektligjit për buxhetin e vitit 2024 me një situatë buxhetore tërësisht të ndryshuar. Kjo situatë ka tre vjet, që pas miratimit të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, e cila ka ardhur paralel me ndryshimet e tjera të mëdha që ka pasur ky institucion në kuadrin e një reforme të thellë dhe falë një mbështetjeje gjithnjë në rritje të qeverisë.

Në materialin që ju kemi dërguar kemi bërë një analizë në detaje të situatës aktuale reale buxhetore të Akademisë së Shkencave për vitin 2023-2024 dhe nuk do të ndalem në detaje për këtë situatë.

Reforma e pagave e ndërmarrë dhe e realizuar nga qeveria në administratën publike, fillimi i një pune intensive për hartimin e veprës madhore “Enciklopedia shqiptare”, krahas punës për përmbylljen e dy veprave të tjera të mëdha “Fjalori i gjuhës shqipe” dhe “Historia e shqiptarëve”, si dhe bashkimi i Akademisë së Studimeve Albanologjike me Akademinë e Shkencave janë ngjarje që përbëjnë thelbin e kërkesave buxhetore të Akademisë së Shkencave për vitin 2024 e në vijim.

Ne kemi bërë vazhdimisht kërkesa për buxhet shtesë, kemi përditësuar gjithnjë ndryshimet dhe zhvillimet e ndodhura. I jemi drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresa zyrtare pa ekzagjruar asgjë në nevojat buxhetore për një aktivitet dhe veprimtari normale të institucionit për kërkimin shkencor, por vërejmë se faktet buxhetore të miratuara në tri vendimet e Këshillit të Ministrave, që janë baza ligjore e planifikimit buxhetor afatmesëm 2024-2026, tregojnë pamjaftueshmëri buxheti për Akademinë e Shkencave.

Referuar projektbuxhetit të vitit 2024 për Akademinë e Shkencave, ku së bashku kemi edhe Akademinë e Studimeve Albanologjike, janë planifikuar gjithsej 437 milionë e 380 mijë lekë. Ky është buxheti i parë që ne fillojmë bashkërisht me Akademinë e Studimeve Albanologjike. Nuk mund të themi se kemi përvojë në menaxhimin e këtij buxheti, por do ta provojmë në vitet në vijim, nga viti 2024 e më tutje.

Efekti financiar si rezultat i reformës së pagave që ka ndërmarrë qeveria për të dyja institucionet ka arritur shifrën 92 milionë lekë. Në total, shpenzimet për pagat, sigurimet shoqërore dhe shpërblimet për titujt e akademikëve gjatë vitit 2023 për të dyja institucionet së bashku arrijnë në shumën 342 milionë lekë. Nëse i referohemi projektbuxhetit që është planifikuar për vitin 2024, kemi një diferencë prej 95 milionë e 380 mijë lekësh, që mendojmë se është e pamjaftueshme për të përballuar të gjithë aktivitetin kërkimor, shkencor dhe atë administrativ në funksion të veprimtarisë shkencore të Akademisë së Shkencave, me të cilën është bashkuar tani edhe Akademia e Studimeve Albanologjike.

Shpenzimet për projektin e enciklopedisë për vitin 2024 nga ana jonë janë llogaritur në detaje në shumën 44 milionë e 100 mijë lekë. Në vitin 2024 do të bëhet një pune intensive për hartimin e enciklopedisë shqiptare. Kjo vepër madhore me rëndësi kombëtare duhet planifikuar detyrimisht në projektbuxhet, pasi buxheti i kërkuar është domosdoshmëri për të vijuar më tej me hartimin dhe realizimin e kësaj vepre.

Nga sa më sipër, qartazi në këtë projektbuxhet, referuar nevojave reale për vitin 2024, të cilat ne i kemi paraqitur në detaje edhe në materialin tonë për Akademinë e Shkencave, dhe

nevojave reale për vitin 2024 për funksionimin e ASA-s bashkë me Akademinë e Shkencave në një institucion të vetëm tani, nuk janë reflektuar ndryshimet për paga, sigurime, shpërblime për titujt e akademikëve, pjesërisht projekti për enciklopedinë. Rezulton që për ASA-n kemi fond vetëm për paga. Vetëm për pagat dhe sigurimet shoqërore të ASA-s në vitin 2024 nevojitet një buxhet prej 228 milionë lekësh.

Mendoj se kjo gjendje duhet të rishikohet dhe të reflektohen kërkesat shtesë që ne kemi pasur, që janë më të domosdoshme dhe që i kemi cilësuar edhe në kërkesë.

Për sa u përket investimeve kapitale, nga historiku që ne kemi marrë deri tani, faktet buxhetore tregojnë se për Akademinë e Shkencave dhe për ASA-n, që tashmë i bashkohet Akademisë së Shkencave, shpenzimet për investime në vite janë pothuajse zero ose minimale. Godinat dhe ambientet ku zhvillohet aktiviteti i përditshëm kanë nevojë emergjente për rikonstrukcion. Nuk mund të flas për Akademinë e Shkencave, që është këtu në qendër, sepse nëse do të vini ndonjë ditë kur bie shi, do të shikoni që çfarë bie jashtë, bie edhe brenda dhe për pasojë po na dëmtohen jashtë mase pajisjet dhe gjëra të tjera që kemi. Pavarësisht ndërhyrjeve që ne mundohemi të bëjmë herë pas here me mbulime të vogla, është e pamundur ta mbrojmë, sepse ajo ka nevojë për një rikonstrukcion total të paktën të çatisë.

Kemi 3 vjet rresht që kërkojmë një buxhet shtesë për investime kapitale, të parashikuara edhe në PBA-në 2024-2026: 50 milionë lekë për vitin 2024, e përfshirë në totalin e kërkesave tona, dhe 50 milionë lekë për vitin 2025, që do të shërbejnë për ndërtimin e një godine këtu ku ne jemi, në një godinë të vjetër që kemi këtu, për të cilën nga ana jonë është bërë edhe një plan-ide dhe një projekt, që është dorëzuar. Kjo godinë do të shërbente për profesorët, akademikët, kërkuesit shkencorë administratën dhe ambiente të tjera që i duhen Akademisë së Shkencave. Kërkesat tona prej 3 vjetësh për të investuar në këtë godinë të re nuk janë marrë parasysh.

(Ndërpritet mbledhja)

(Rifillon mbledhja)

Ruzhdi Kuçi - Patëm një ndërprerje të energjisë.

Evis Kushi - Ju dëgjojmë tani. Mund të vijoni.

Ruzhdi Kuçi - Ndërtimi i një godine të re në ambientet ekzistuese bëhet edhe më e domosdoshme në realitetin e ri që ka sjellë zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave për mbylljen e veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e saj pranë Akademisë së Shkencave.

Kërkesa buxhetore për 32 milionë lekë për Akademinë e Studimeve Albanologjike është planifikuar për shpenzime për rikonstruksione, siç është shtëpia e arkeologëve në Apoloni, ndërtesa e Institutit të Antropologjisë, si dhe shpenzime për fonde, arkivat dhe bibliotekën në funksion të modernizimit të tyre.

Diferencën prej 10 milionë lekësh në zërin “231” ne e kemi parashikuar dhe e kemi projektuar vazhdimisht për investime dhe qendra laboratorike në mbështetje të veprimtarisë kërkimore shkencore. Në këto vite është parashikuar të ngrihen: Qendra Kombëtare e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës, pasurimi i laboratorit epidemiologjik me pajisje të reja, ngritja e laboratorit të antropologjisë dhe e qendrës kombëtare, dhe në një të ardhme të afërt edhe rajonale, të NanoAlb-it, e të tjera projekte që kemi.

Situata e re buxhetore e krijuar në Akademinë e Shkencave si rezultat i bashkimit të Akademisë së Shkencave dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe e ngritjes së njërive të reja kërkimore shkencore në bazë të ligjit nr. 59/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” kërkon domosdoshmërisht që modeli i financimit për kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese të njërive të kërkim-studimit të realizohet nga buxheti i shtetit në formë granti. Mendoj se këtë ndryshim që ka sjellë me vete realiteti i ri financiar Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet ta kishte reflektuar në projektbuxhetin e vitit 2024, që po diskutojmë aktualisht.

Një kërkesë e tillë rrjedh edhe nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 338, paragrafi i parë, për mbylljen e veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e saj pranë Akademisë së Shkencave, që transferon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e ASA-s tek Akademia e Shkencave, përfshirë këtu edhe të drejtat financiare që ajo kishte dhe ka aktualisht.

Këto institute e njësi kërkimore duhet të vijojnë të financohen me doemos me të njëjtën formë që financohen institucionet e arsimit të lartë nga buxheti i shtetit: në formë granti. Në të kundërt, për mendimin tonë, realizimi i misionit dhe i qëllimit me të cilin të gjitha këto institute dhe njësi kërkimore janë ngritur pranë Akademisë së Shkencave do të jetë i vështirë. Në 2-3 vjetët e fundit po hasim vështirësi sidomos te planifikimi, sepse, sipas mendimit tim, nuk kemi të bëjmë me mallra dhe shërbime, por kemi të bëjmë me krijimtari, kërkim shkencor, që jo gjithmonë është ajo që planifikohet dhe mund ta blesh direkt.

Akademia e Shkencave i është drejtuar edhe Këshillit të Ministrave me një projektvendim për ngritjen dhe organizimin e njërive të kërkim-studimit në shkencat albanologjike pranë

Akademisë së Shkencave, në një nga pikat e të cilit përfshihet edhe kjo kërkesë që unë sapo e citova.

Në përfundim, buxheti i parashikuar në projektbuxhetin e vitit 2024 për Akademinë e Shkencave dhe Akademinë e Studimeve Albanologjike rezulton i pamjaftueshëm dhe nuk përmbush nevojat reale për veprimtarinë normale kërkimore dhe shkencore të tyre.

Duke iu referuar buxhetit të parashikuar për vitin 2024 për institucionin e Akademisë së Shkencave dhe nevojave reale që të dyja akademitë kanë së bashku, dua të përsëris në mënyrë të përmbledhur kërkesat për buxhet shtesë: për shpenzimet korrente kërkojmë minimalisht rreth 127 milionë e 120 mijë lekë, kurse për shpenzimet kapitale 82 milionë lekë. Ne i kemi të ndara edhe në detaje dhe jua kemi dërguar. Totali i kërkesave, bashkë me investimet, shkon 209 milionë e 120 mijë lekë.

Kërkoj mirëkuptimin tuaj dhe mbështetjen tuaj si komision për këto kërkesa që kemi si Akademi e Shkencave.

Faleminderit!

Evis Kushi – Zoti Kuçi, faleminderit për fjalën tuaj dhe për shqetësimet e ngritura!

Me sa kuptova, ju thoni se nuk janë reflektuar në buxhetin e vitit 2024 ndryshimet që kanë ndodhur në strukturën tuaj apo vendimet e fundit të Këshillit të Ministrave, pra që lidhen me institucionin tuaj, me Akademinë e Shkencave apo me Akademinë e Studimeve Albanologjike.

Kështu, po ia kaloj menjëherë fjalën zotit Gentian Opre, drejtor i Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për të dhënë sqarime në lidhje me këto mungesa që ju pretendoni se nuk janë në buxhet.

Ju lutem, zoti Opre, jeni në linjë?

Atëherë, deri sa të lidhet zoti Opre nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, po ua kaloj fjalën menjëherë kolegëve të komisionit, deputetëve, nëse kanë pyetje në lidhje me prezantimin tuaj apo me buxhetin në përgjithësi për Akademinë e Shkencave.

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë, nëse nuk ka më pyetje...

Po, zoti Beqiraj, por do t'ju lutesha të ishit konciz nëse keni pyetje, pasi e keni marrë ju të gjithë kohën e këtij komisioni.

Ismet Beqiraj – Faleminderit për sugjerimin, zonja drejtuese e komisionit, por nuk është faji im që angazhohem dhe të tjerët...

Evis Kushi – Jo, jo, faleminderit për angazhimin!

Ismet Beqiraj – ...kanë respekt për mua dhe thonë: “I konsumoi Ismeti dhe nuk po bëjmë pyetje”.

Evis Kushi – Mirë.

Ju lutem, shumë shpejt!

Ismet Beqiraj – Po.

Sigurisht, reforma e madhe që u bë në institucionin më të rëndësishëm të vendit tonë, që është Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, është krenaria e një institucioni të lartë shkencor dhe kërkues në vendin tonë, me të cilën mbrohen identitete të rëndësishme të profilit shkencor për vetë ekzistencën e kombit tonë, siç janë gjuha, historia, fjalori, enciklopedia, shkenca e të tjera e të tjera, por nuk do të ndalem te këto.

Sigurisht që unë për këtë vit, personalisht, duke qenë edhe një bashkëpunëtor, dhe jo vetëm në kuadër të reformimit të kësaj Akademie, me të nderuarit akademikë, me ju dhe me shumë kolegë të këtij komisioni të nderuar, në legjislaturën para kësaj, po edhe në këtë legjislaturë e dimë se reformimi, në radhë të parë kërkon financim. Ama, kur shikova shifrat totale simbolike, ajo që më shqetësoi, e para, ishte se buxheti afatmesëm i planifikuar është me trend rënës, marr rastin konkret të planifikimit për vitin 2026, që është 111 milionë e 500 mijë lekë, të rinj i bie.

Pra, do të thotë që kalojnë vitet dhe nevojat e kërkimit shkencor, njësitë e kërkim-studimit, që ia dha me ligj ligjvënësi në ligjin e vitit 2019, do ta korrektoj numrin e ligjit më vonë, se nuk po më kujtohet tamam, pra ia dha me ligj për shërbim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si? Po, ligji nr. 53/2019.

...që këto përse me rënie? E kam më shumë ndaj përfaqësuesve të Ministrisë së Financave, që kanë hartuar planifikimin buxhetor për këtë institucion.

E dyta, është në nderin e këtij komisioni, po edhe në nderin e vetë ne, deputetëve, dhe të këtij Kuvendi që ndërtesa jonë gjitane të ketë nevojë për një rikonstruksion total që duhej të ishte parashikuar si zë i veçantë mënjane. Ndoshta është, por më duket një rikonstruksion i thjeshtë, sa për të ndërruar tjegullat dhe çarjet e mureve dhe tavaneve. Në fakt, duhet të jetë një Akademi Shkencore bashkëkohore dhe dinjitoze. Hajdeni shkojmë ta shikojmë si e ka Kosova, jo më ndonjë vend tjetër, shumë dinjitoz! Ndaj edhe kjo godinë duhej të kishte planifikim.

Nga ana tjetër, me të drejtë, edhe unë nuk do ta quaja anormale, që në planifikimin buxhetor nuk parashikohen shtesat e përfituara në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore për pagat.

Vëllimi i punës së Akademisë është në zgjerim e sipër, madje ne jemi koshientë se tri projektet të mëdha të gjuhës shqipe, të historisë së Shqipërisë të fjalorit të madh shqip e kapërcejnë një projektbuxhet afatmesëm. Ndaj duhet të ishin të planifikuara edhe në zëra. Madje, me të drejtë, në ndryshimet e fundit të ligjit “Për Akademinë e Shkencave” u kërkua të futej si një shtesë edhe e drejta e transferimit të fondeve që bëhen të pakonsumuara, gjë të cilën e kemi sqaruar edhe me ministrinë.

Besoje se nuk përbëjnë pengesë fondet që transferohen nga njëri vit në tjetrin, edhe pse janë të pakonsumuara, pasi nuk është si puna e ndërtimit të një shtëpie, që ka norma e standarde ndërtimi dhe e planifikon me një marzh gabimi të vogël periudhën e ndërtimit.

Këto janë projekte madhore studimore që kanë, gjithashtu, vështirësitë e tyre objektive dhe subjektive nga fillimi deri në rrugën e gjatë të përfundimit të tyre.

Ndaj, unë u bashkohem edhe kërkesave që kanë bërë përfaqësuesit e Akademisë së Shkencave, në mënyrë që shtesa e fondeve nuk bëhet për mëshirë ndaj këtij institucioni, por duhet të jetë në nderin tonë, sepse ua bëjmë bartësve të dijës, të kulturës, të shkencës, të historisë dhe janë të një institucioni, me plot gojën, akademi, e cila kërkon ta ketë vendin e saj të nderuar edhe në vlerësim.

Faleminderit!

Evis Kushi – Zoti Beqiraj, shumë faleminderit për diskutimin tuaj, natyrisht edhe për kontributin tuaj!

Na janë bashkuar në mbledhje zoti Opre dhe zonja Dhëmbi nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Ju lutem, një përgjigje për shqetësimin e ngritur nga Akademia e Shkencave për mosreflektimin e ndryshimeve që kanë ndodhur në strukturë apo për mosreflektimin e vendimeve të fundit të Këshillit të Ministrave lidhur me këtë institucion.

Kush do ta marrë fjalën, zoti Opre apo zonja Dhëmbi?

Po, zoti Opre, fjala për ju.

Gentian Opre – Faleminderit!

Përshëndetje!

Lidhur me nivelin e pagave të Akademisë së Shkencave, desha të sqaroj se ne i kemi reflektuar, domethënë, në projektbuxhetin e vitit 2024, efektet e reja financiare të strukturës së re dhe niveleve të pagave të reja të Akademisë së Shkencave, por kemi disa diskordanca lidhur me dy-tri pozicione që nuk janë në nivelin e parashikuar me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore.

Presim edhe vendimmarrjen e fundit të Kuvendit, pasi strukturat e nivelit të pagave kalojnë me vendim të Kuvendit, gjë që nuk ka ndodhur ende. Ama, këto janë diferenca shumë të vogla që nuk përbëjnë problem në vijueshmërinë e punës së Akademisë së Shkencave. Pra, në total jemi në linjë me parashikimet buxhetore që kemi për këtë zë për Akademinë e Shkencave.

Faleminderit!

Evis Kushi – Faleminderit, zoti Opre!

Nuk e di nëse ka ndonjë çështje tjetër, ndonjë pyetje apo diskutim në lidhje me pjesën që i takon Akademisë së Shkencave.

Nëse jo, atëherë, falënderojmë zotin Kuçi, zotin Perolli dhe zonjën Monka nga Akademia e Shkencave dhe Akademia e Studimeve Albanologjike për prezencën!

Shumë faleminderit!

Kërkesat dhe shqetësimet tuaja janë regjistruar dhe, patjetër, ne do të kemi edhe komunikime e bashkëpunime të tjera në vijim.

Ju urojmë punë të mbarë dhe shumë suksese!

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2023, ora 16:00

Drejton mbledhjen:

Evis Kushi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2.Diskutimi dhe miratimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”

Marrin pjesë:

Evis Kushi, Lindita Buxheli, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Ilir Topi, Ilir Metaj, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Eslemvera Zake, Meri Markici, Ina Zhupa, Kastriot Piroli, Eralda Bano, Merita Bakiu, Orjela Nebijaj dhe Ismet Beqiraj (zëvendësues).

Mungojnë:

Flutura Aça, Petro Koçi, Andia Ulliri dhe Agron Gjekmarkaj.

Të ftuara:

Albana Tole – zëvendësministre e Arsimit dhe Sportit,

Mirela Bimo – drejtore e Financës dhe Buxhetit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit,

Zerina Bruci – sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Kulturës,

Adela Xhemali – zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë,

Mimoza Dhëmbi – drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Evis Kushi – Ndërkohë, të nderuar kolegë, ne vijojmë me pikën e fundit të rendit të ditës për këtë mbledhje: diskutimi dhe miratimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

Përveç deputetëve anëtarë të komisionit, ne kemi të ftuar edhe përfaqësuesit e ministrive, respektivisht, zonjat Tole dhe Bimo nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, zonjën Bruci nga Ministria e Kulturës, si dhe zonjat Xhemali dhe Dhëmbi nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Fillimisht, unë po prezantoj relacionin e komisionit dhe, më pas, do të hap menjëherë seancën për pyetje dhe diskutime.

Atëherë, të nderuar kolegë, të nderuar deputetë,

Më lejoni të prezantoj para jush disa vlerësime për projektbuxhetin e vitit 2024.

Në fakt, komisioni ynë, ai për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, e shqyrton këtë projektligj sipas fushës së tij të përgjegjësisë, duke përfshirë Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, sa i përket arsimit profesional, dhe Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Nuk po ndalem gjatë në bazën kushtetuese dhe aspektin procedural, sepse, me siguri, Komisioni i Ligjeve ka më shumë kompetencë në këtë drejtim, por mjafton të theksoj që projektligji vjen në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, si dhe me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë këtyre dy javëve, komisioni ynë ka zhvilluar seanca për diskutimin në parim me ministritë e linjës, si dhe seanca dëgjimore me institucionet e pavarura dhe agjencitë që operojnë në këta sektorë, të cilët kanë prezantuar punën e tyre, objektivat dhe prioritetet kryesore të projektbuxhetit për vitin 2024.

Shpreh keqardhjen që opozita, me ndonjë përjashtim, në momente të caktuara jo vetëm që nuk ka marrë pjesë në këtë diskutim që është, në fakt, ligji më i rëndësishëm i shtetit shqiptar, sipas të cilit operojnë të gjitha institucionet, por as nuk ka lejuar mazhorancën të zhvillojë seanca normale në mjediset e Kuvendit, duke bllokuar sallën e mbledhjeve, korridoret, mjediset dhe duke shkaktuar edhe skena të pakëndshme kaosi. Megjithatë, ne nuk jemi ndalur, kemi vijuar punën me korrektësi, me seriozitet, duke u dhënë të gjithë kohën e nevojshme si ministrave, zëvendësministrave, të ftuarve nga institucionet, por, po ashtu, edhe deputetëve për të shprehur vlerësimet, shqetësimet dhe sugjerimet e tyre për ndryshimet apo përmirësimet në projektbuxhet.

Një nga lajmet më të mira të buxhetit të vitit 2024 është se ai do të mbështesë politikën e rritjes së pagave në administratën publike qendrore dhe vendore, e cila ka nisur që në vitin 2023 dhe që do të vijojë në fund të muajit qershor 2024, duke përfshirë edhe rritjen e pagës për punonjësit e sistemit arsimor, sikurse edhe për sistemin shëndetësor, punonjësit me grada, nëpunësit e administratës publike. Në total politika e rritjes së pagave do të kushtojë 39,1 miliardë lekë, duke përmbushur edhe objektivin e pagës mesatare në sektorin publik prej 900 euro në muaj, çka është edhe një angazhim i kësaj mazhorance.

Investimet publike për vitin 2024 janë planifikuar në masën 5,3% të prodhimit të brendshëm bruto ose 128,5 miliardë lekë. Në këtë fond përfshihet dhe fondi i rindërtimit nga tërmeti në shumën 7 miliardë lekë, ku përveç transportit, zhvillimit urban dhe rajonal, përfshihen edhe objekte arsimore, si dhe trashëgimia kulturore dhe e turizmit.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për qeverisjen qendrore për vitin 2024, parashikohen në masën 63,2 miliardë lekë ose rreth 2,6% të produktit të brendshëm bruto. Në këtë zë janë programuar edhe politikat që lidhen me mbështetjen për arsimin e sportin, por edhe zhvillimin e turizmit, mirëmbajtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit e të tjera.

Shpenzimet për subvencione janë parashikuar në masën 1,85 miliardë lekë, me një rritje të lehtë nga buxheti i rishikuar i vitit 2023. Kjo rritje i dedikohet zbatimit të skemës së garancisë rinore, e cila në bashkëfinancim me Bashkimin Europian, synon të sigurojë një ofertë cilësore punësimi për të rinjtë e moshës 16-29 vjeç, të regjistruar si punëkërkues të papunë.

Unë nuk do të ndalem shumë në detaje të çështjeve makroekonomike, siç është rritja ekonomike që në vitin 2024 parashikohet 3,8%, apo ulja e borxhit publik nën 60% të produktit të brendshëm bruto, apo rritja e të ardhurave gati sa dyfishi i nivelit të vitit 2013, pasi këto janë të gjitha çështje të trajtuara gjerësisht përgjatë këtyre javëve nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat, por dua të fokusohem më shumë në secilin nga sektorët që mbulon komisioni ynë.

Konkretisht, projektbuxheti i vitit 2024 për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, parashikohet në masën 52 miliardë e 223 milion lekë, me një shtesë fondi prej 5 miliardë e 49 milionë lekë ndaj buxhetit fillestar të vitit 2023, ose një rritje prej 10,7%. Ky është buxheti më i lartë historik për arsimin, i cili mbështet politikën e rritjes së pagave për mësuesit, rritjen e investimeve në infrastrukturën arsimore dhe atë digjitale në shkolla, zgjeron financimin për programet e arsimit të lartë, programet e ndërkombëtarizimit dhe kërkimit shkencor dhe siguron mbështetjen e studentëve. Buxheti i vitit 2024 do të mbështesë sportin, duke investuar në disiplinat sportive në

shkolla, programet e masivizimit të sportit, si dhe sportit elitari. Buxheti për arsimin mbështet investimet kapitale në fondin prej 5 miliardë e 704 milionë lekë, 25% më shumë se buxheti fillestar i vitit 2023, ku do të vijojë mbështetja për investimet në infrastrukturën e arsimit bazë, arsimit të mesëm dhe atë të lartë, si dhe mbështetja për infrastrukturën e kërkimit shkencor.

Sa i takon arsimin profesional, projektbuxheti për vitin 2024 për arsimin profesional është 3 miliardë e 530 milion e 469 mijë lekë, dhe synon të përmbushë qëllimin kryesor të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030, si dhe planin e saj të veprimit, duke garantuar arsim dhe formim profesional cilësor dhe gjithëpërfshirës. Disa nga objektivat specifike të projektbuxhetit të vitit 2024 lidhen, së pari, me rritjen e aksesit në arsimin e mesëm profesional, duke synuar që në vitin 2024 të tërhiqen 18,2% e nxënësve që ndjekin ciklin e arsimit të mesëm nga 17,7% që parashikohet të arrijë në fund të vitit 2023. Gjithashtu, parashikohet rritja e përqindjes së të punësuarve pas diplomimit në shkollat e mesme profesionale në 60% të totalit që mbarojnë studimet në vitin 2024, krahasuar me 57,5% që ishte në vitin 2023. Po kështu, parashikohet rritja e numrit të nxënësve që vijnë nga zonat rurale, që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale nga 43% e totalit në vitin 2023 në 45% të totalit në vitin 2024.

Së fundi, parashikohet edhe rritja e numrit të nxënësve me romë dhe egjiptianë që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale nga 670 nxënës në vitin 2023, në 710 nxënës në vitin 2024.

Për sa i takon Ministrisë së Kulturës, projektbuxheti arrin vlerën 4 miliardë e 123 milionë e 741 mijë lekë, që do të thotë 14% më i lartë krahasuar me vitin 2023. Edhe këtu prioriteti kryesor mbetet intensifikimi i përpjekjeve për realizimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025, siç është mbështetja e aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë dhe promovimi e përfaqësimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore shqiptare në evenimentet e rëndësishme ndërkombëtare.

Rritja e buxhetit për pagat është 29% më shumë se viti 2023, ndërsa investimet 30% më shumë. Kështu, buxheti do të mbështesë iniciativat që lidhen me javët kulturore ndërkombëtare, aktivitetet që lidhen me sezonin turistik, përfaqësimi në Bienalen e Artit në Venezia, si dhe rritet ndërkombëtare të operës, teatrit dhe filmit. Po ashtu, do të investohet në objektet e artit, të trashëgimisë kulturore, muzetë, si dhe projekte e konkurse kombëtare në të gjithë vendin. Do të çohen përpara projekte ambicioze, si restaurimi i Muzeut Historik Kombëtar, muzeu “Besa”, amfiteatri i Durrësit, teatri “Aleksandër Moisiu”, dhe burgu i Spaçit.

Unë nuk po zgjatem më shumë, të gjithë kolegët kemi pasur mundësi t'i diskutojmë në detaje të gjithë zërat e këtij buxheti me ministritë përkatëse, me agjencitë, me institucionet e pavarura, kështu që unë po e mbyll këtu fjalën time dhe menjëherë jua jap fjalën, të nderuar kolegë, për ndonjë pyetje apo për ndonjë sugjerim, apo diskutim që lidhet me projektbuxhetin, përpara se të kalojmë në pjesën e fundit që është votimi për miratimin në parim.

Kush e do fjalën? Kolegë, e ka kërkuar njeri fjalën?

Atëherë, në qoftë se nuk kemi ndonjë gjë për të thënë, se i kemi ezauruar me sa duket diskutimet edhe pyetjet gjatë seancave, bëhemi gati për procesin e votimit, duke verifikuar fillimisht kuorumin për të garantuar që jemi mbi 50%. Atëherë, kemi zotin Beqiraj, zotin Ndreca, zonjën Buxheli, zotin Spaho, zonjën Gjylameti, zonjën Tahiraj, zotin Topi, zonjën Teuta Ramaj, zonjën Meri Markiçi, zonjën Eni Zake, jemi në pritje të disa kolegëve që më njoftojnë se kanë problem dhe po futen në linjë menjëherë.

Vetëm 2 minuta pushim, sa të kalojmë në procesin e votimit.

Ju lutem, mos u largoni!

Atëherë, kolegë, jemi gati për votim. Ju lutem, hapni kamerat!

Kolegë, kush është pro për miratimin në parim të projektbuxhetit të vitit 2024? I lutem sekretarisë së komisionit të numërojë votat. Në total janë 11 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji "Për buxhetin e vitit 2024".

Të nderuar kolegë, shumë faleminderit për diskutimet, për kontributin, për pyetjet, për gjithçka që kemi diskutuar në këto seanca!

Shumë faleminderit përfaqësuesit nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë!

Mbledhjen këtu e deklaroj të mbyllur. Do të njoftoheni për mbledhjen e radhës nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit!

Punë të mbarë të gjithëve! Suksese!

MBYLLET MBLEDHJA

